



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

PROJEKTLIGJI PËR MBROJTJEN E BIMËVE

DRAFT LAW ON PLANT PROTECTION

NACRT ZAKONA O ZAŠTITI BILJA

<p>KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS,</p> <p>Në bazë të nenit 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton:</p> <p>PROJEKTLIGJIN PËR MBROJTJEN E BIMËVE</p> <p>KREU I</p> <p>DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME</p> <p>Neni 1</p> <p>Qëllimi</p> <p>1.Ky ligj rregullon të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me:</p> <p>1.1 mbrojtjen e bimëve, të produkteve bimore dhe objekteve të tjera të përfshira në prodhimtarinë bimore;</p> <p>1.2 përcaktimin e masave për parandalimin e hyrjes dhe përhapjes së organizmave të dëmshëm në bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera dhe për zhdukjen e tyre;</p> <p>1.3 lehtësimin e mbledhjes dhe këmbimit të informatave dhe të dhënave me vende të tjera;</p> <p>1.4 financimin dhe kompensimin për punët e kryera në lëmin e</p>	<p>THE ASSEMBLY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO,</p> <p>Pursuant to 65 (1) of the Constitution of Republic of Kosovo,</p> <p>Adopts:</p> <p>DRAFT LAW ON PLANT PROTECTION</p> <p>CHAPTER I</p> <p>GENERAL PROVISIONS</p> <p>Article</p> <p>Aim</p> <p>1.This law regulates all activities related to:</p> <p>1.1 protecting plants, plant products and other objects included in plant production;</p> <p>1.2 identifying measures for the prevention of introduction and spread of harmful organisms in plants, plant products and other objects and for their eradication;</p> <p>1.3 favouring the collection and exchange of information and data with other countries;</p> <p>1.4 financing and compensating works undertaken on plant</p>	<p>SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA</p> <p>Na osnovu članu 65.1. Ustava Republike Kosova</p> <p>Usvaja:</p> <p>NACRT ZAKON O ZAŠTITI BILJA</p> <p>POGLAVLJE I</p> <p>OPŠTE ODREDBE</p> <p>Član 2</p> <p>Cilj</p> <p>1.Ovaj zakon reguliše sve aktivnosti koji se odnose na:</p> <p>1.1. zaštitu bilja, biljnih proizvoda drugih objekta uključenim u biljnu proizvodnju;</p> <p>1.2. utvrđivanju mera radi sprečavanje unošenje, širenje štetnih organizama i njihovo za biljke, biljne proizvode I drugih objekte i njihovo iskorenjivanje;</p> <p>1.3. olakšavanje prikupljanja i razmene informacija i podataka sa drugim zemljama;</p> <p>1.4.financiranje i nadoknadu za obavljene poslove u oblasti zaštite</p>
--	---	---

<p>mbrojtjes së bimëve; 1.5 përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësiive të subjekteve të përfshira në mbrojtjen e bimëve dhe zbatimin e këtij ligji në Kosovë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 2 Fushëveprimi</p> <p>1. Ky ligj siguron kushtet për: 1.1 mbrojtjen e bimëve dhe produkteve bimore nga organizmat e dëmshëm; 1.2 parandalimin e futjes dhe përhapjes së organizmave të dëmshëm dhe zhdukjen e tyre; 1.3 identifikimin e organizmave të dëmshëm; 1.4 prodhimtari optimale dhe qarkullimin e bimëve dhe produkteve bimore; 1.5 zbatimin e mbikëqyrjes së përhershme të organizmave të dëmshëm, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve të tyre, zbatimin e masave për mbrojtjen e bimëve dhe kryerjen e detyrave dhe raporteve të tjera; 1.6 orientimin dhe monitorimin e zhvillimit të veprimtarive lidhur me mbrojtjen e bimëve; 1.7 mbledhjen, ruajtjen dhe këmbimin e të dhënave dhe informatave;</p>	<p>protection; 1.5 designating tasks and responsibilities of the subjects involved in the plant protection and in the application of this Law in Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">Article 2 Scope of work</p> <p>1. This law provides the conditions for: 1.1 the protection of plants and plant products against harmful organisms; 1.2 the prevention of introduction and spread of harmful organisms and their eradication; 1.3 the identification of harmful organisms; 1.4 the optimal production and transfer of plants and plant products; 1.5 the implementation of permanent supervision of harmful organisms, of their risk assessment and management, of plant protection measures, and performance of other duties and reports; 1.6 the orientation and monitoring of the development of activities concerned with plant protection; 1.7 the collection, maintenance and exchange of data and information;</p>	<p>bilja; 1.5. utvrđivanje zadatka i odgovornosti subjekata uključenim u zaštitu bilja i u sprovođenju ovog zakona na Kosovu.</p> <p style="text-align: center;">Član 2 Delokrug</p> <p>1. Ovaj zakon obezbeđuje uslove za: 1.1. zaštitu bilja i biljnih proizvoda od štetnih organizma; 1.2. sprečavanje unošenje, širenje štetnih organizama i njihovo iskorenjivanje; 1.3. identifikaciju štetnih organizma; 1.4. optimalna proizvodnja i promet bilja i biljnih proizvoda; 1.5. sprovođenje stalnog nadzora nad štetnim organizmima, procenu I menažiranje njihovog rizika, sprovođenje mera za zaštitu biljka i vršenje drugih zadataka i izveštaja; 1.6. usmerenje i monitoring razvoja delatnosti u vezi zaštite bilja; 1.7. prikupljanje, čuvanje i razmena podataka i informacija;</p>
---	---	--

<p>1.8 edukimin e popullatës dhe ngritjen e vetëdijes së saj lidhur me mbrojtjen e bimëve.</p> <p style="text-align: center;">Neni 3 Përkufizimet</p> <p>1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:</p> <p>1.1 Deklarim plotësues - Deklarim i cili kërkohet nga një vend importues ku malli duhet të futet me një Certifikatë Fitosanitare, me të dhëna plotësuese specifike për një dërgesë lidhur me organizmat e dëmshëm të rregulluar me këtë ligj;</p> <p>1.2 Mall - Lloj bime, produkti bimor ose artikull tjetër i cili qarkullohet për tregti apo qëllime të tjera;</p> <p>1.3 Organ kompetent – Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Departamenti i Prodhimit dhe Mbrojtjes së Bimëve;</p> <p>1.4 Dërgesë - Një sasi bimësh, produktesh bimorë dhe objektesh të tjera të cilat lëvizin nga një vend në një tjetër dhe shoqërohen, kur kërkohet, me një certifikatë të vetme fitosanitare, ku një dërgesë mund të përbëhet nga një apo më shumë mallra apo ngarkesa;</p> <p>1.5 Dërgesë në transit - Një dërgesë e cila kalon nëpër një vend pa u importuar dhe që mund t'u nënshtrohet</p>	<p>1.8 the education of the community and raising its awareness in regard to plant protection.</p> <p style="text-align: center;">Article 3 Definitions</p> <p>1. Used expressions in this law has the following meaning:</p> <p>1.1 Additional Declaration - A statement that is required by an importing country to be entered on a Phytosanitary Certificate and which provides specific additional information on a consignment in relation to harmful organisms regulated by this law;</p> <p>1.2 Commodity - A type of plant, plant product, or other article being moved for trade or other purpose;</p> <p>1.3 Competent organ - Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development of Kosovo - Department of Plant Production and Protection;</p> <p>1.4 Consignment - A quantity of plants, plant products and other objects being moved from one country to another and accompanied, when required, by a single phytosanitary certificate, where a consignment may be composed of one or more commodities or lots;</p> <p>1.5 Consignment in transit - A consignment which passes through the country without being imported, and</p>	<p>1.8. edukacija stanovništva i podizanje svesti građana o zaštiti bilja.</p> <p style="text-align: center;">Član 3 Definicije</p> <p>1. Upotrebljeni izrazi za potrebe ovog zakona imaju sledeće značenje:</p> <p>1.1 Dodatna deklaracija – Deklaracija koja se traži od zemlje uvoznika gde roba treba da se uvozi uz Fitosantiarno uverenje sa dodatnim specifičnim podacima sa jednu dostavu u vezi štetnih organizma, ovim zakonom regulisano;</p> <p>1.2 Roba – vrsta biljke, biljnih proizvoda ili drugi artikal koji se stavlja u promet radi trgovine ili u druge svrhe;</p> <p>1.3 Nadležni organ – Ministarstvo poljoprivrede, šumarstva i ruralnog razvoja-Departman proizvodnje i zaštite bilja;</p> <p>1.4 Pošiljka - količina biljaka, biljnih proizvoda i drugih objekata koja se premeštaju od jednog do drugog mesta i kada se to traži, uz jedinstvenog fitosanitarnog uverenja kada se jedna pošiljka može da se sastoji od jedne ili više roba ili tovara;</p> <p>1.5 Pošiljka u tranzitu – pošiljka koja prolazi preko jedne zemlje bez uvoza a može podvrgnuti se fitosanitarnim</p>
---	---	--

<p>kontrolleve fitosanitare të cilat sigurojnë që dërgesa të mbetet e mbyllur, të mos ndahet, apo kombinohet me ngarkesa të tjera dhe as t'i ndryshohet paketimi;</p> <p>1.6 Vend i origjinës - Vendi në të cilin janë kultivuar bimët dhe bimët nga të cilat janë përfituar produktet bimore;</p> <p>1.7 Eksport - Transport i bimëve, produkteve bimore dhe objekteve me origjinë nga Kosova në vende të tjera;</p> <p>1.8 Organizma të dëmshëm - Parazitë e patogjenë të bimëve apo produkteve bimore, të cilat i përkasin botës bimore apo shtazore ose viruse, fitoplazma apo patogjenë të tjerë;</p> <p>1.9 Vlerësim i organizmave të dëmshëm - Procedurë zyrtare e grumbullimit, ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave mbi praninë e organizmave të dëmshëm në bimë, në bazë të përcjelljes së gjendjes shëndetësore, të hulumtimeve sistematike, kontrollit inspektues apo procedurave të tjera si dhe të dhënave plotësuese;</p> <p>1.10 Import - Çfarëdo futje e dërgesave në pikat hyrëse të Kosovës, pa marrë parasysh destinimin e tyre sipas Ligjeve Doganore, përveç kalimit transit;</p> <p>1.11 Leje Importi - Dokument zyrtar i</p>	<p>that may be subject to phytosanitary checkings and which ensure that the consignment remains enclosed, is not split up, combined with other consignments nor has its packaging changed;</p> <p>1.6 Country of Origin - Country where the plants and the plants from which the plant products are derived were grown;</p> <p>1.7 Export - Transport of plants, plant products and other objects of Kosovo origin to other countries;</p> <p>1.8 Harmful organisms – Parasites of pathogenes of plants or of plant products, which belong to the animal or plant kingdoms, or which are viruses, phytoplasmas or other pathogens;</p> <p>1.9 Harmful organism's evaluation - Official procedure of collection, maintenance and processing of data on the presence of harmful organisms in plants, based on the follow up of the health conditions, systematic research, inspection control or other procedures as well as complementary sources;</p> <p>1.10 Import - Any introduction of consignments in the points of entry of Kosovo, without considering its destination according to the Customs Laws, other than transit.</p> <p>1.11 Import Permit - Official</p>	<p>kontrolama koje obezbeđuju da pošiljka bude zatvorena, da se ne odvoja ili kombinira sa drugim teretima niti da se pakovanje promeni;</p> <p>1.6 Mesto prekla - podrazumeva mesto gde su biljke uzgajane ili su od njih dobijeni biljni proizvodi;</p> <p>1.7 Izvoz - transport biljaka, biljnih proizvoda, proizvodnih objekata pod nadzorom poreklom iz Kosova;</p> <p>1.8 Štetni organizmi - paraziti i patogeni biljaka i biljnih proizvoda koje pripadaju organizme biljnog i životinjskog porekla i patogeni koji u raznim oblicima prouzrokuju štete na biljke, biljne proizvode i na druge objekte;</p> <p>1.9 Procena štetnih organizama - podrazumeva službeni postupak prikupljanja, čuvanja i obrade podataka o prisustvu štetnih organizama na biljku, praćenjem zdravstvenog stanja, sistematskim istraživanjem, inspeksijskim kontrolama ili drugim postupcima kao i dopunskim izvorima;</p> <p>1.10 Uvoz - podrazumeva svako unošenje pošiljke na graničnim tačkama Kosova, bez obzira na njihovu namenu prema graničnim zakonima, osim tranzita;</p> <p>1.11 Dozvola za uvoz - službeni</p>
---	---	---

<p>cili autorizon importin e një malli në përputhje me kërkesat specifike fitosanitare për import;</p> <p>1.12 Inspektim - Ekzaminim vizual zyrtar i bimëve , produkteve bimore apo objekteve të tjera për të përcaktuar praninë ose jo të organizmave të dëmshëm dhe/apo për të përcaktuar në se janë përmbushur rregullat fitosanitare;</p> <p>1.13 Inspektor - Person i autorizuar nga Ministria për zbatimin e këtij ligji;</p> <p>1.14 Hyrje - Hyrje e një organizmi të dëmshëm në zona në të cilat prania e tyre nuk ka qenë e vërtetuar më parë dhe që rezultoi në pranishëm;</p> <p>1.15 Listë e organizmave të dëmshëm - Listë e organizmat e dëmshëm, hyrja dhe përhapja e të cilave është e ndaluar apo e trajtuar me këtë ligj;</p> <p>1.16 Ngarkesë – Numër i njësisë të një malli të vetëm të identifikueshme për nga homogjeniteti i përbërjes, origjinës, etj. si pjesë të një dërgese;</p> <p>1.17 Ministria - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;</p> <p>1.18 Monitorim - Proces zyrtar i vazhdueshëm për verifikimin e situatave fitosanitare;</p> <p>1.19 Kontroll zyrtar - Zbatim aktiv i ligjeve dhe akteve nënligjore fitosanitare dhe zbatim i procedurave të detyrueshme fitosanitare me objektiv</p>	<p>document authorizing importation of a commodity in accordance with specified phytosanitary import requirements;</p> <p>1.12 Inspection - Official visual examination of plants, plant products or other objects to determine, if harmful organisms are present and/or to determine compliance with phytosanitary regulations.</p> <p>1.13 Inspector - Person authorized by the Ministry to enforce this Law;</p> <p>1.14 Introduction - Entry of a harmful organism in areas whereby its occurrence was not reported before and resulting in its establishment;</p> <p>1.15 List of harmful organisms - List of harmful organisms whose introduction and spreading is prohibited or regulated by this law;</p> <p>1.16 Lot - A number of units of a single commodity, identifiable by its homogeneity of composition, origin etc., forming part of a consignment;</p> <p>1.17 Ministry - Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development;</p> <p>1.18 Monitoring - An official ongoing process to verify phytosanitary situations;</p> <p>1.19 Official control - The active enforcement of mandatory phytosanitary regulations and the application of mandatory</p>	<p>dokument koji ovlašćuje uvoz robe u skladu sa specifičnim fitosanitarnim zahtevima;</p> <p>1.12 Inspekcija - vizuelno zvanično ispitivanje biljka, biljnih proizvoda ili drugih objekta radi utvrđivanja prisutnosti ili ne prisutnosti štetnih organizama i/ili radi utvrđivanja da li su ispunjeni fitosanitarna pravila;</p> <p>1.13 Inspektor – ovlašćeno lice iz Ministarstva za provođenje ovog zakona;</p> <p>1.14 Ulaz – Ulaz štetnog organizma u području na kojima njihova prisutnost ranije nije utvrđena i pošto rezultira da je prisutan.</p> <p>1.15 Spisak štetnih organizma – Spisak štetnih organizma čiji ulaz i proširenje zabranjeno ili tretirano ovim zakonom;</p> <p>1.16 Tovar – broj jedinica jedne jedinstvene robe identifikovano prema homogenosti sastava, porekla i dr. kao delovi jedne pošiljke;</p> <p>1.17 Ministarstvo - Ministarstvo poljoprivrede, šumarstva i ruralnog razvoja;</p> <p>1.18 Monitoring – zvanični i stalni proces radi verifikacije fitosanitarnih situacija;</p> <p>1.19 Službena kontrola - aktivno sprovođenje zakona i pod zakonskih fitosanitarnih akata i sprovođenje obaveznih fitosanitarnih procedura sa</p>
--	---	--

<p>zhdukjen ose kufizimin e veprimit të organizmave të dëmshëm karantinorë ose menaxhimin e parazitëve jo karantinorë që trajtohen në këtë ligj. që përfshin:</p> <p>1.19.1 zhdukjen ose kufizimin e tyre në zonat e infektuara;</p> <p>1.19.2 mbikëqyrjen në zonat e rrezikuara; dhe</p> <p>1.19.3 masat lidhur me kontrollet e lëvizjeve drejt e brenda zonës apo zonave të mbrojtura, përfshirë masat që aplikohen në importim.</p> <p>1.20 Objekte të tjera - Vende, pajisje për ruajtje, trajtime, përpunime të bimëve dhe produkteve bimore, materiale paketimi, mjete transportuese, kontejnerë, apo materiale të tjera që përdoren për kultivimin e bimëve dhe organizmave të tjerë, mjete dhe materiale të cilat mund të përmbajnë dhe bartin organizma të dëmshëm për bimët që u nënshtrohen masave fitosanitare;</p> <p>1.21 Organizëm i dëmshëm - Çdo lloj, soji, shtam apo biotip bimor, shtazor ose agjent patogjen i dëmshëm për bimët ose produktet bimore;</p> <p>1.22 Analizë e rrezikut të Organizmave të dëmshëm - Procesi i vlerësimit të të dhënave biologjike apo i të dhënave të tjera shkencore dhe ekonomike për të përcaktuar nëse një organizëm është i dëmshëm dhe nëse duhet të trajtohet në ligj dhe shkallën e</p>	<p>phytosanitary procedures with the objective of eradication or containment of quarantine pests or for the management of regulated non-quarantine pests that are treated in this law including:</p> <p>1.19.1 eradication and/or containment in the infested area;</p> <p>1.19.2 surveillance in the endangered area(s); and</p> <p>1.19.3 measures related to controls on movement into and within the protected area(s) including measures applied at import.</p> <p>1.20 “Other objects” - Places, facilities for storing, treating, processing plants and plant products, packaging material, means of transport, containers, soil or other material used for cropping plants and other organisms, means and materials which can carry and bear harmful organisms to plants that require the initiation of phytosanitary measures;</p> <p>1.21 Pest - Any species, strain or biotype of plant, animal or pathogenic agent injurious to plants or plant products;</p> <p>1.22 Pest Risk Analysis - The process of evaluating biological or other scientific and economic evidence to determine whether an organism is a pest, whether it should be regulated, and the strength of any phytosanitary measures to be taken</p>	<p>ciljem iskorenjivanja ili ograničavanja delovanja štetnih karantinskih organizma ili upravljanje ne karantinskim parazitima koji se tretiraju ovim zakonom i koje obuhvataju:</p> <p>1.19.1 njihovo iskorenjivanje ili ograničavanje u inficiranim zonama;</p> <p>1.19.2 nadzor nad inficiranim zonama; i</p> <p>1.19.3 mere u vezi kontrole kretanja u pravcu zone ili zaštićenih zona uključujući i mere koje se primenjuju u uvozu.</p> <p>1.20 Drugi objekti – Mesta, oprema za čuvanje, tretiranja, preradu biljaka i biljnih proizvoda, materijali za pakovanje, transportna sredstva koja se koriste za uzgajavanje biljaka i drugih organizma, sredstva i materijali koji bi mogli sadržati i prenositi štetne organizme za biljke i koji podleže fitosanitarnim merama;</p> <p>1.21 Štetan organizam – svaka vrsta, rod, shtam ili biljni, životinjski biotip ili patogeni agens štetan po bilje ili biljne proizvode;</p> <p>1.22 Analiza opasnosti štetnih organizama-proces procene bioloških podataka ili drugih naučnih i ekonomskih podataka radi utvrđivanja da jedan organizam je štetan i ako treba da se tretira zakonom i stepen opasnosti fitosanitarnih mera koje se</p>
---	---	--

<p>rreptësisë së masave fitosanitare që merren kundër tij;</p> <p>1.23 Vlerësim i rrezikut nga organizmat e dëmshëm – Vlerësim i probabilitetit të hyrjes dhe përhapjes të një organizmi të dëmshëm dhe i madhësisë së pasojave të mundëshme ekonomike që bart;</p> <p>1.24 Menagjimi i rrezikut nga organizmat e dëmshëm - Vlerësim dhe zgjedhja e rrugëve të ndryshme për të ulur rrezikun e hyrjes dhe përhapjes së një organizmi të dëmshëm;</p> <p>1.25 Certifikatë Fitosanitare - Dokument zyrtar i cili vërteton gjendjen fitosanitare të çdo dërgese që i nënshtrohet ligjeve fitosanitare dhe e cila shoqëron dërgesat e bimëve për eksport, të importuara apo në kalim transit;</p> <p>1.26 Masa fitosanitare – Çdo ligj, akt nënligjor apo procedurë zyrtare që ka për qëllim të parandalojë hyrjen ose përhapjen e organizmave të dëmshëm karantinorë ose të kufizojë pasojat ekonomike të organizmave të dëmshëm jo karantinorë që trajtohen në këtë ligj;</p> <p>1.27 Inspekcioni Fitosanitar – Organi përgjegjës për inspektimin e dërgesave bimore gjatë import-eksportit të tyre dhe për kontrollin e territorit nëpërmjet inspektorëve fitosanitarë;</p> <p>1.28 Legjislacioni Fitosanitare - Ky Ligj dhe çdo akt nënligjor, rregulloret, udhëzimet apo tjetër vendim</p>	<p>against it;</p> <p>1.23 Pest risk assessment - Evaluation of the probability of the introduction and spread of a harmful organism and the magnitude of the associated potential economic consequences;</p> <p>1.24 Pest risk management - Evaluation and selection of options to reduce the risk of introduction and spread of a harmful organism;</p> <p>1.25 Phytosanitary certificate - An official document which attests to the phytosanitary status of any consignment affected by phytosanitary regulations and which accompanies the exported, imported or transit plant consignments;</p> <p>1.26 Phytosanitary measure - Any legislation, regulation or official procedure having the purpose to prevent the introduction and/or spread of quarantine harmful organisms, or to limit the economic impact of regulated non-quarantine pests treated in this law;</p> <p>1.27 Phytosanitary inspection - Body responsible of inspections on plant consignments in import/export and control of the territory through its phytosanitary inspectors;</p> <p>1.28 Phytosanitary Legislation - this Law and any act, law, regulation, guideline or other administrative order</p>	<p>preduzimaju protiv njemu;</p> <p>1.23 Procena opasnosti od štetnih organizama – procena probaliteti ulaska i proširenja štetnog organizma i veličine mogućih posledica koje on nosi;</p> <p>1.24 Menažiranje opasnosti od štetnih organizama - procena i izbor različitih načina radi smanjenja opasnosti od ulaska i proširenja štetnog organizma;</p> <p>1.25 Fitosanitarni sertifikat- Službeni dokument koji potvrđuje fitosanitarno stanje svake pošiljke koja podleže fitosanitarnim zakonima i koja prati biljne pošiljke za izvoz, uvoz ili u tranzitu;</p> <p>1.26 Fitosanitarne mere – svaki zakon, pod zakonski akt ili službena procedura koja ima za cilj da sprečava ulazak ili proširenje karantinskih štetnih organizama ili da ograničava ekonomske posledice štetnih ne karantinskih organizama koje se ovim zakonom tretiraju;</p> <p>1.27 Fitosanitarna inspekcija – odgovorni organ za inspekciju biljnih pošiljka tokom njihovih uvoza- izvoza i za kontrolu područja pomoću fitosanitarnih inspektora;</p> <p>1.28 Fitosanitarno zakonodavstvo – Ovaj Zakon i svaki drugi pod zakonski akt, pravilnici, uputstva ili druga</p>
---	--	--

<p>administrativ i nxjerrë nga ministria si edhe kontratat dhe marrëveshjet ndërkombëtare për mbrojtjen e bimëve;</p> <p>1.29 Vendi i prodhimit – Çdo vend apo grupim tokash e trajtuar si njësi e vetme prodhimi apo fermë,që mund të përfshijë vendet e prodhimit të cilat menaxhohen të veçuara për qëllime fitosanitare;</p> <p>1.30 Produkte bimore – Produkte të papërpunuara me origjinë bimore si drithëra dhe produkte të përpunuara, të cilat falë natyrës së tyre apo përpunimit, mund të krijojnë rrezik për hyrjen dhe përhapjen e organizmave të dëmshëm. Produktet bimore përfshijnë edhe drurin nëse ai e ruan sipërfaqen e tij në kushte natyrore ose pjesë të tij, me apo pa lëvore, të përpunuara në formë të pllakave të prera, pjesëza, tallash, mbetje ose copëza, dru i gdhendur, material ambalazhi druri, material paketimi prej druri të përpunuar që përdoret për transportimin e dërgesave të ndryshme;</p> <p>1.31 Pasaportë bimore – Dokumenti i lëshuar nga organi kompetent ku dëshmohet se janë përmbushur standardet e shëndetit të bimëve dhe kërkesat specifike në fuqi për bimët dhe produktet bimore brenda territorit të Kosovës;</p> <p>1.32 Karantinë bimore - Të gjitha veprimtaritë e përcaktuara për të parandaluar hyrjen dhe përhapjen e organizmave të dëmshëm karantinorë</p>	<p>promulgated by the Ministry as well as contracts and international agreements on plant protection;</p> <p>1.29 Place of production - Any premises or collection of fields operated as a single production or farming unit that may include production sites which are separately managed for phytosanitary purposes;</p> <p>1.30 Plant products - Unmanufactured material of plant origin including grain and those manufactured products that, by their nature or that of their processing, may create a risk for the introduction and spread of harmful organisms. Plant products include also wood, if it preserves its surface in natural conditions or its parts, with or without bark, processed in the form of cut slabs, fractions, sawdust, wood remains or particles, carved wood, wooden packaging material, wood processed packaging material used to transport different consignments;</p> <p>1.31 Plant passport - Document issued by the competent body which gives evidence that the standards of plant health and specific requirements for plant and plant products in force within the territory of Kosovo are satisfied;</p> <p>1.32 Plant quarantine - All activities designed to prevent the introduction and/or spread of quarantine harmful organisms or to ensure their official</p>	<p>administrativna odluka doneta od strane ministra kao i međunarodni ugovori i sporazumi o zaštiti bilja;</p> <p>1.29 Mesto proizvodnje – svako mesto ili grupisanje zemljišta tretirano kao pojedinačna proizvodna jedinica ili farma koja može obuhvatiti mesta proizvodnje koja se upravljaju odvojeno u fitosanitarne svrhe;</p> <p>1.30 Biljni proizvodi – ne prerađivani proizvodi biljnog porekla, kao što su žitarice i prerađeni proizvodi koja zahvaljujući njihove prirode ili prerade,mogu stvoriti rizik za ulazak I proširenje štetnih organizama.U biljnom proizvodu spadaju drvo, ako on čuva celu njegovu površinu u prirodnom stanju ili njegovi delovi, sa ili bez kore, prerađen u obliku sečenih ploča, odseći, piljevina, drveni ostatci ili deliçi drveta, rezano drvo, drvena ambalaža, materijal za pakovanje izrađenog od drveta koji služi za transport raznih pošiljka;</p> <p>1.31 Biljni pasoš - dokumenat izdat od nadležnog organana ,gde se dokazuje da su ispunjeni standardi zdravlja bilja i specifični zahtevi na snazi za biljke i biljne proizvode koji su u prometu unutar teritorija Kosova;</p> <p>1.32 Biljni karantin – sve utvrđene delatnosti radi sprečavanja ulaza i proširenja karantinskih štetnih organizama ili obezbeđenje njihove</p>
---	--	--

<p>apo sigurimin e kontrollit zyrtar të tyre; 1.33 Bimë - Bimë të gjalla ose pjesë të tyre të gjalla duke përfshirë frytin në kuptim botanik me përjashtim të atyre që ruhen me ngrirje të thellë, perimet, tuberë, bulbe, rizoma, lule të prera me ose pa gjemba, degë me gjethe, degë të prera me gjethe si, kultura indore bimore, micel i kërpudhave dhe polen i gjallë, farëra dhe gjermoplazmën;</p> <p>1.34 Bimë për mbjellje - bimë të përcaktuara të mbeten të mbjellur apo rimbjellur;</p> <p>1.35 Pikë e hyrjes – Aeroport ose pikë kufitare tokësore e përcaktuar zyrtarisht për importimin e dërgesave, ku inspektori fitosanitar në bashkëpunim me kontrollin Doganor janë të autorizuar të kontrollojnë dërgesa të importuara, eksportuara ose riekportuara;</p> <p>1.36 Prodhues në bujqësi - Personi fizik apo juridik i cili është pronar, apo merret me prodhimin, përpunimin, trajtimin, ruajtjen, tregtimin, shpërndarjen apo ndonjë përdorim tjetër të bimëve dhe produkteve bimore;</p> <p>1.37 Certifikatë për Riekport – certifikatë që lëshohet për dërgesat që riekportohen mbasi që inspektimet zyrtare kanë siguruar se në dërgesën e re nuk ka rreziqe fitosanitare;</p>	<p>control;</p> <p>1.33 Plants - Living plants and parts thereof, including fruit in the botanical sense other than that preserved by deep freezing, vegetables other than those preserved by deep freezing, tubers, corms, bulbs, rhizomes, cut flowers with or without horns, branches with foliage, cut branches with foliage such as plant tissue cultures, fungi mycelium and live pollen, seeds and germplasm;</p> <p>1.34 Plants for planting - Plants intended to remain planted, to be planted or replanted;</p> <p>1.35 Point of entry - Airport or land border point officially designated for the importation of consignments, where phytosanitary inspector in cooperation with the Customs Services are authorized to check imported, exported or re-exported consignments;</p> <p>1.36 Producer in agriculture - Legal entity or physical person who is the owner, or deals with the production, processing, handling, storing, trading, delivering or any other usage of plants and plant products;</p> <p>1.37 Re-export Certificate - Certificate issued for re-exported consignments after that official inspections have ensured no phytosanitary risks are present in the</p>	<p>zvanične kontrole;</p> <p>1.33 Biljke - žive biljke ili njeni živi delovi uključujući i plod u botaničkom smislu izuzev onih koja se čuvaju dubokim zamrzavanjem, povrće, tuberi, bulbe, rizoma, sečeni cvetovi sa ili bez trnja, grane sa lišćima, sečena grana sa lišćem kao indijska biljna kultura, micel gljiva i živi polen, semena i geroplazma;</p> <p>1.34 Biljke za setvu - biljke namenjene da ostanu zasađene ili da se ponovo sade;</p> <p>1.35 Ulazna tačka - aerodrom ili granična kopnena tačka zvanično utvrđena za uvoz pošiljki, gde fitosanitarni inspektor u saradnji sa Carinskom kontrolom ovlašćeni su da kontrolišu uvozne, izvozne pošiljke i ponovo izvozne pošiljke;</p> <p>1.36 Proizvođač u poljoprivredi - fizičko ili pravno lice koje je vlasnik, ili se bavi proizvodnjom, preradom, tretiranjem, uskladištenjem, trgovinom, distribucijom ili drugom upotrebom biljaka i biljnih proizvoda;</p> <p>1.37 Sertifikat za reizvoz - uverenje koja se izdaje za pošiljke koja se ponovo izvoze nakon što su zvanični inspektori obezbedili da u novoj pošilci nema fitosanitarne opasnosti;</p>
--	---	---

<p>1.38 Dërgesë e rieksportuar – Dërgesë e cila ka qenë importuar në një vend nga i cili më pas është eksportuar. Dërgesa mund të ruhet, ndahet, kombinohet me dërgesa të tjera ose t'i ndryshohet paketimi - drejt vendit të rieksportit;</p> <p>1.39 Regjistrim – akti i miratimit të aktivitetit të prodhimit të bimëve dhe produkteve bimore nga organi kompetent;</p> <p>1.40 Territor nën trajtim ligjor - Një zonë në të cilën, brenda së cilës dhe nga e cila bimët, produktet bimore dhe artikuj të tjerë të trajtuar në këtë ligj ju nënshtrohen rregulloreve fitosanitare apo procedurave në mënyrë që të parandalohen hyrja dhe përhapja e organizmave të dëmshëm karantinorë ose që të kufizohet ndikimi ekonomik i organizmave të dëmshëm jo karantinorë që rregullohen me këtë ligj;</p> <p>1.41 Farëra – Farëra për t'u mbjellë apo që destinohen për mbjellje dhe jo për konsum apo përpunim;</p> <p>1.42 Mbikëqyrje – Proces zyrtar gjatë të cilit grumbullohen dhe mbahen shënime të dhëna mbi shfaqjen e organizmave të dëmshëm apo mungesën e tyre nëpërmjet shqyrtimeve, monitorimit apo procedurave të tjera;</p> <p>1.43 Provë – Ekzaminim zyrtar, jo vizual për të përcaktuar nëse</p>	<p>new consignment;</p> <p>1.38 Re-exported consignment - Consignment that has been imported into a country from which it is then exported. The consignment may be stored, split up, combined with other consignments or have its packaging changed - formerly country of re-export;</p> <p>1.39 Registration - Act of approval of the activity of plant production and plant products by the Competent organ;</p> <p>1.40 Regulated area - An area into which, within which and/or from which plants, plant products and other regulated articles are subjected to phytosanitary regulations or procedures in order to prevent the introduction and/or spread of quarantine harmful organisms or to limit the economic impact of non-quarantine pests regulated by this law;</p> <p>1.41 Seeds - Seeds for planting or intended for planting and not for consumption or processing;</p> <p>1.42 Surveillance - An official process which collects and records data on harmful organisms occurrence or absence by survey, monitoring or other procedures;</p> <p>1.43 Test - Official examination, other than visual, to determine, if</p>	<p>1.38 Reizvozna pošiljka - pošiljka koja je uvezena iz jedne zemlje od koje je zatim izvozena. Pošiljka može se čuvati, podeliti, kombinirati sa drugim pošiljkama ili izmeniti pakovanje – u pravcu zemlje reizvoza;</p> <p>1.39 Registracija akta usvajanja aktivnosti proizvodnje biljaka i biljnih proizvoda od strane nadležnog organa;</p> <p>1.40 Područje pod zakonskim tretiranjem - područje unutar kojeg i od koje biljke, biljni proizvodi i drugi artikli ovim zakonom tretirani podležu fitosanitarnim ili proceduralnim pravilnicima kako bi se onemogućio ulazak i širenje štetnih karantinskih organizama ili da se ograniči ekonomski uticaj štetnih ne karantinskih organizama što se reguliše ovim zakonom;</p> <p>1.41 Seme - seme za setvu ili namenjena setvi za potrošnju ili preradu;</p> <p>1.42 Nadzor - službeni proces tokom kojeg prikupljaju i vode se beleške o podacima pojavljivanja štetni organizama ili njihovom izostanku preko razmatranja, monitoringa ili drugih procedura;</p> <p>1.43 Proba – službeno ne vizuelno ispitivanje radi utvrđivanja da li su</p>
---	--	---

<p>organizmat e dëmshëm janë të pranishëm ose për të identifikuar organizmat e dëmshëm;</p> <p>1.44 Transferim – Çfarëdo transferim i bimëve, produkteve bimore, materialeve dhe objekteve të tjera jashtë vendit të prodhimit brenda territorit të Kosovës;</p> <p>1.45 Zyrtar publik – angazhimi i ndonjë personi fizik apo juridik për të kryer ndonjë aktivitet të caktuar nga Ministria në fushën e mbrojtjes së bimëve.</p> <p style="text-align: center;">KREU II MBROJTJA E BIMËVE</p> <p style="text-align: center;">Neni 4 Detyrat kryesore</p> <p>1. Mbrojtja e bimëve përfshinë:</p> <p>1.1 identifikimin, përcjelljen, parandalimin e hyrjes dhe përhapjes së organizmave të dëmshëm në bimë, produkte bimore dhe objekte tjera dhe zhdukjen apo kontrollimin e tyre;</p> <p>1.2 përcaktimin dhe zbatimin e masave fitosanitare;</p> <p>1.3 kryerjen e përgjegjësisë dhe detyrave të përcaktuara nga konventat ndërkombëtare, kontratat dhe marrëveshjet për mbrojtjen e bimëve.</p>	<p>harmful organisms are present or to identify harmful organisms;</p> <p>1.44 Transfer - Any transfer of the plants, plant products, other materials and other objects outside their place of production within the territory of Kosovo.</p> <p>1.45 Public Official – any natural or legal person engaged to carry out assigned activities by the Ministry in the plants protection field.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER II PLANT PROTECTION</p> <p style="text-align: center;">Article 4 Main duties</p> <p>1. Plant protection include:</p> <p>1.1 identification, monitoring, prevention of introduction and spreading of harmful organisms in plant, plant production and other objects and disappearance or their control;</p> <p>1.2 determination and implementation of phytosanitary measures;</p> <p>1.3 performances of duties and responsibilities defined by international conventions, contracts and agreements for plant protection.</p>	<p>štetni organizmi prisutni ili radi identifikacije štetnih organizma;</p> <p>1.44 Transfer – svako prenošenje bilja, biljnih proizvoda, materijala i drugih objekta van mesta proizvodnje unutar područja Kosova.</p> <p>1.45 Javni službenik – angažovanje nekog fizičkog ili pravnog lica radi obavljanja bilo kakvu aktivnost određenu od Ministarstva u oblasti zaštite bilja.</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE II ZAŠTITA BILJA</p> <p style="text-align: center;">Član 4 Glavni zadaci</p> <p>1. Zaštita bilja obuhvata:</p> <p>1.1 identifikaciju i praćenje, sprečavanje i širenje štetnih organizama na biljke, biljne proizvode, na ostale objekte i njihovo iskorenjivanje ili kontroll;</p> <p>1.2 određivanje i sprovođenje fitosanitarnih mera;</p> <p>1.3 realizaciju obaveza i zadataka koja potiču iz međunarodnih konvencija, ugovora i sporazuma o zaštiti biljaka.</p>
---	---	--

<p align="center">Neni 5 Palët dhe detyrat në fushën e mbrojtjes së bimëve</p>	<p align="center">Article 5 Parties and duties in the field of plant protection</p>	<p align="center">Član 5 Stranke i obaveze u oblasti zaštite bilja</p>
<p>1. Mbrojtja e bimëve është përgjegjësi e Organit Kompetent, e Inspektionit fitosanitar, zyrtarëve publikë të ngarkuar për mbrojtjen e bimëve sipas nenit 52 i këtij ligji dhe prodhuesve bujqësorë.</p> <p>2. Ministria, Inspektioni fitosanitar, zyrtarët publik të ngarkuar për mbrojtjen e bimëve dhe prodhuesit bujqësorë duhet të bashkëpunojnë vazhdimisht për përcjelljen e gjendjes së shëndetit të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera, në mënyrë që të identifikohet e raportohet hyrja dhe përhapja e organizmave të dëmshëm si dhe për zhdukjen apo kontrollin e tyre.</p> <p>3. Ministria, nëpërmjet organeve të veta ekzekutive, mbikëqyr, koordinon dhe propozon ligje dhe akte nënligjore për mbrojtjen e bimëve, farërave, bimëve për mbjellje, produkteve për mbrojtjen dhe ushqimin e bimëve.</p> <p>4. Zyrtarët publik të ngarkuar me mbrojtjen e bimëve duhet të njoftojnë menjëherë inspektorët fitosanitarë dhe organin kompetent për shfaqjet e reja e të papritura të organizmave të dëmshëm të Listave I.A. dhe II.A.</p> <p>5. Çdo person i cili për nga natyra e punës së tij vëren apo dyshon për shfaqje të re e të papritur të organizmave të dëmshëm në bimë, duhet të njoftojë organin kompetent për mbrojtjen e bimëve apo inspektorët</p>	<p>1. Plant protection is the responsibility of the competent organ, Phytosanitary inspectorate, Public officers charged in plant protection according to art. 52 under this Law and producers in agriculture.</p> <p>2. The Ministry, the Phytosanitary inspection, the Public officers charged in plant protection and the producers in agriculture shall perform and cooperate permanently in following up the health of plants, plant products and other objects, in order to identify and report on the introduction and spread of harmful organisms and to eradicate or-control them.</p> <p>3. The Ministry, through its executive bodies, supervises, coordinates and proposes laws and legislative acts on the protection of plants, seeds, plants intended for planting, products for protection and plant nutrients.</p> <p>4. Public officers charged in plant protection shall immediately inform the phytosanitary inspectors and competent organ on the new and unexpected occurrences of the harmful organisms from List I.A. and II. A.</p> <p>5. Any person who due to the nature of its job recognize or is suspicious about the new and unexpected occurrence of harmful organisms in plants shall inform the competent organ for plant protection</p>	<p>1. Zaštita bilja je odgovornost nadležnog organa i fitosanitarne inspekcije, javnih zvaničnika zaduženih za zaštitu bilja na osnovu člana 52. ovog zakona i poljoprivednih proizvođača.</p> <p>2. Ministarstvo, Fitosanitarne inspekcija, javni zvaničnici zaduženi za zaštitu bilja i poljoprivredni proizvođači treba da stalno saraduju radi praćenja zdravlja biljaka, biljnih proizvoda i drugih objekta kako bi se identifikovalo i izvestilo ulazak i širenje štetnih organizama kao i njihovo iskorenjivanje i kontrola.</p> <p>3. Ministarstvo preko svojih izvršnih organa kontroliše, koordinira i predlaže zakone i pod zakonske akte o zaštiti bilja, semena, biljaka za sadnju, proizvoda za zaštitu i ishrani biljaka.</p> <p>4. Javni zvaničnici zaduženi za zaštitu bilja treba da odmah obaveste fitosanitarne inspektore i nadležnog organa o novim i neočekivanim pojavljivanjima štetnih organizama iz Liste I.A i II:A.</p> <p>5. Svako lice koji iz prirode svojih poslova primećuje ili sumnja o novom neočekivanom pojavljivanju štetnih organizma u biljkama treba da obavesti nadležni organ za zaštitu bilja ili</p>

<p>fitosanitarë.</p> <p>6. Përsa i përket mbrojtjes së shëndetit të bimëve pyjore, organi kompetent dhe zyrtarët publik të ngarkuar me mbrojtjen e pyjeve duhet ta ushtrojnë punën e tyre në pajtim me këtë Ligj dhe aktet nënligjore të tij.</p> <p style="text-align: center;">Neni 6 Përgjegjësitë e prodhuesve bujqësor</p> <p>1. Prodhuesi bujqësor është përgjegjës për:</p> <p>1.1 kontrollin e shëndetit të bimëve gjatë kultivimit të tyre, për të identifikuar e parandaluar përhapjen e organizmave të dëmshëm në zonat ku kultivohen si: ngastra, plantacione, fidanishte, pemtore, serra, bimë natyrore dhe produktet bimore, si edhe objekte të tjera në pronësi të tij apo që dikush tjetër i shfrytëzon në emër të tij;</p> <p>1.2 njoftimin e inspektionit fitosanitar apo zyrtarëve publik të ngarkuar me mbrojtjen e bimëve për shfaqje të reja e të papritura apo për dyshime mbi praninë e organizmave të dëmshëm në bimë të Listave I.A. dhe II.A. ata duhet të njoftojnë menjëherë organin kompetent të Ministrisë;</p> <p>1.3 marrjen e menjëhershme të masave të përcaktuara nga organi kompetent apo inspeksioni</p>	<p>and/or the phytosanitary inspectors.</p> <p>6. In regard to the protection of the health of forest plants, the competent organ and the public officers charged in forestry protection shall perform their activity in accordance to this Law and its sub-legal acts.</p> <p style="text-align: center;">Article 6 Responsibilities of agriculture producers</p> <p>1.Producer in agriculture is responsible for:</p> <p>1.1 control of plant health controlling plant health during their growth, in order to identify and prevent the spread of harmful organisms in areas whereby plants are grown such as: plots, plantations, nursery, gardens, orchards, greenhouses, natural plants and plant products as well as other objects he owns or someone else uses on his behalf;</p> <p>1.2 informing the phytosanitary inspectorate or public officers charged in plant protection on new and unexpected occurrences or suspicion about the presence of harmful organisms to the plants of List I.A. and II.A. They shall immediately inform the competent organ of the Ministry;</p> <p>1.3 taking immediate measures, designated by the competent organ or the phytosanitary inspectorate in</p>	<p>fitosanitarne inspektore.</p> <p>6. Što se tiče zaštite šumskih biljka, nadležni organ i javni zvaničnici zaduženi za zaštitu bilja treba da obavljaju svoj posao u skladu sa ovim Zakonom i njegovim pod zakonskim aktima.</p> <p style="text-align: center;">Član 6 Odgovornosti poljoprivrednih proizvođača</p> <p>1.Poljoprivredni proizvođač je odgovoran o:</p> <p>1.1 kontroli zdravlja bilja tokom njihovog uzgajanje adi identifikacije i sprečavanja širenje štetnih organizma u zonama gde uzgajaju kao: parcele, plantaže, jaslice, voćnjaci, sere, prirodne biljke i biljne proizvode kao i druge objekte u njegovom vlasništvu ili neko koristi u njegovo ime.</p> <p>1.2 upoznavanje fitosanitarne inspekcije ili javnih zvaničnika zaduženi sa zaštitom bilja o novim neočekivanim pojavama ili o sumnjama o prisustvu štetnih organizma u biljkama iz Liste I:A i II:A. Oni odmah treba da obaveste nadležni organ Ministarstva.</p> <p>1.3 momentalnom preduzimanju mera utvrđenih od strane nadležnog organa ili fitosanitarnog inspektorata,</p>
--	---	---

<p>fitosanitar, në mënyrë që të pengohet përhapja dhe të zhduken organizmat e dëmshëm;</p> <p>1.4 mbajtjen e shënimeve për masat e ndërmarra për mbrojtjen e bimëve dhe lejimin e personave zyrtarë për kontrollimin e tyre;</p> <p>1.5 lejimin dhe ndihmën gjatë kryerjes së kontrollit inspektues fitosanitar.</p> <p>2.Nëse prodhuesi bujqësor nuk zbaton masat e përcaktuara në nënparagrafin 1.1 dhe 1.3 të këtij neni, inspektori fitosanitar përcakton zbatimin e tyre në vend të prodhuesit bujqësor.</p> <p>3.Me përjashtim të dispozitave të nënparagrafit 1.1 dhe 1.3 të këtij neni, prodhuesi bujqësor i cili është pronar apo shfrytëzues i bimëve pyjore, është përgjegjës për të njoftuar menjëherë inspektorët pyjorë dhe zyrtarët publik të ngarkuar me mbrojtjen e pyjeve për shfaqjen e organizmave të dëmshëm të Listave I.A. dhe II.A., të cilët menjëherë njoftojnë organin kompetent për mbrojtjen e bimëve në pajtim me nenin 5, paragrafi 4 i këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;">KREU III</p> <p style="text-align: center;">PARANDALIMI I HYRJES DHE PËRHAPJES SË ORGANIZMAVE TË DËMSHËM NË BIMË, PRODUKTE BIMORE DHE NË OBJEKTE TË TJERA DHE MASAT PËR LUFTIMIN APO ZHDUKJEN E TYRE</p>	<p>order to impede the spread and eradicate the harmful organisms;</p> <p>1.4 keeping evidence on the measures taken on the protection of plants and to allow official persons to check it;</p> <p>1.5 enabling and assisting in performing the phytosanitary inspection check.</p> <p>2.If the producer in agriculture does not implement the measures designated in paragraph 1.1 and 1.3 of this article, the phytosanitary inspector designates their implementation on behalf of the–producer in agriculture.</p> <p>3. Except for the provisions of paragraph 1.1 and 1.3 of this article, the producer in agriculture who is the owner or user of forest plants is responsible to inform immediately on the occurrence of harmful organisms form List I.A and II.A. the forest inspectors and the Public officers charged in forestry protection, which immediately inform the competent organ for the protection of plants in accordance with Article 5, paragraph 4 of this Law.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER III</p> <p style="text-align: center;">PREVENTION OF INTRODUCTION AND SPREAD OF HARMFUL ORGANISMS TO PLANTS, PLANT PRODUCTS AND OTHER OBJECTS AND MEASURES FOR THEIR CONTROL OR ERADICATION</p>	<p>kako bise spreçilo proširenje i da se iskorene štetni organizmi;</p> <p>1.4 vođenje podataka o preduzetim merama za zaštitu bilja i dozvolu zvaničnih lica za njihovu kontrolu;</p> <p>1.5 dozvola i pomoć tokom izvršenja inspeksijske fitosanitarne kontrole.</p> <p>2.Ukoliko poljoprivredni proizvođač ne sprovodi mere utvrđenim pod stavom 1.1. i 1.3. ovog člana, fitosanitarni inspektor u mesto poljoprivrednog proizvođača utvrđuje njihovo sprovođenje.</p> <p>3.Izuzetno od odredba pod stava 1.1. i 1.3. ovog člana, poljoprivredni proizvođač koji je vlasnik ili korisnik šumskih biljka, odgovoran je da odmah obavesti šumske inspektore i javne zvaničnike zaduženim zaštitom biljka o pojavi štetnih organizama iz Liste I:A i II:A, koji odmah obaveštavaju nadležnog organa za zaštitu biljka u skladu sa članom 5. stav 4. ovog zakona.</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE III</p> <p style="text-align: center;">SPREČAVANJE ULASKA I ŠIRENJA ŠTETNIH ORGANIZAMA NA BILJKE, BLJNIM PROIZVODIMA I NA DRUGE OBJEKTE I MERE ZA NJIHOVO SUZBIJANJE I ISKORENJAVANJE</p>
---	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 7 Listat e organizmave që rregullohen me këtë ligj</p>	<p style="text-align: center;">Article 7 The Lists regulated harmful organisms by this Law</p>	<p style="text-align: center;">Član 7 Lista organizama koja se reguliše zakonom</p>
<p>1.Organizmat e dēmshēm, sipas rrezikut për shëndetin e disa lloje bimësh dhe sipas natyrës së dēmeve ekonomike në bimët e kultivuara dhe ato pyjore, klasifikohen në listat vijuese:</p> <p>Lista I.A.: organizma të dēmshēm, hyrja dhe përhapja e të cilëve ndalohet në territorin e Kosovës dhe prania e të cilave nuk është vërtetuar në ndonjë pjesë të vendit;</p> <p>Lista I.A.1.: organizma të dēmshēm, hyrja dhe përhapja e të cilëve ndalohet në territorin e Kosovës edhe nëse është vërtetuar prania e tyre në ndonjë bimë të veçantë apo produkte bimore ose në zona të kufizuara;</p> <p>Lista I.B.: organizma të dēmshēm, hyrja dhe përhapja e të cilave ndalohet në zonat e mbrojtura të Kosovës;</p> <p>Lista II.A.: organizma të dēmshēm, hyrja dhe përhapja e të cilëve në Kosovë duhet të ndalohet edhe nëse janë të pranishme në disa bimë apo produkte bimore dhe shaqja e të cilave nuk është e vërtetuar në ndonjë pjesë të vendit;</p> <p>Lista II.A.I organizma të dēmshme, hyrja dhe përhapja e të cilave në</p>	<p>1.Harmful organisms, according to the health risk on some plants species and according to the nature of economic damages caused to crops and forest plants, are part of this law and are classified in the following lists:</p> <p>List I.A.: harmful organisms whose introduction into and spread within the territory of Kosovo is prohibited and whose occurrence is not known to occur in any part of the country;</p> <p>List I.A.1.: harmful organisms whose introduction into and spread within the territory of Kosovo is prohibited even though their occurrence is known in special plants or plant products or in limited areas;</p> <p>List I.B.: harmful organisms whose introduction into and spread within protected zones of Kosovo is prohibited;</p> <p>List II.A. harmful organisms whose introduction and spread in Kosovo shall be prohibited, if they are present on certain plants or plant products and whose occurrence is not known to occur in any part of the country.</p> <p>List II.A.I: harmful organisms whose introduction and spread in</p>	<p>1.Štetni organizmi prema riziku po zdravlje nekih vrsta bilja i prema prirodi ekonomske štete na uzgajane i šumske biljke klasifikuju se na sledećim listama:</p> <p>Lista I.A.: štetni organizmi, čije unošenje i širenje na teritoriji Kosova je zabranjeno a čije prisustvo nije utvrđeno na nekom delu zemlje;</p> <p>Lista I.A.1.: štetni organizmi čije unošenje i širenje na teritoriji Kosova je zabranjeno i ako je primećeno njihovo prisustvo na nekoj posebnoj biljci ili biljnom proizvodu ili na ograničenim zonama;</p> <p>Lista I.B.:štetni organizmi, čije je unošenje i širenje na zaštićenim zonama Kosova zabranjeno.</p> <p>Lista II.A.:štetni organizmi, čije je unošenje i širenje na Kosovu treba zabraniti i ako su prisutne na neke biljke ili biljne proizvode čija pojava na nekom delu zemlje nije utvrđena.</p> <p>Lista II.A.I.: štetni organizmi čije unošenje i širenje na Kosova treba</p>

<p>Kosovë duhet të ndalohet në se janë të pranishme në disa bimë apo produkte bimore edhe në se dihet prania e tyre në vend.</p> <p style="text-align: center;">Neni 8 Lista e dërgesave bimore të rregulluara me këtë ligj</p> <p>1. Bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera të cilët bartin organizma të dëmshëm që rrezikojnë shëndetin e bimëve, hyrja dhe përhapja e të cilave në vend duhet të rregullohet me këtë ligj dhe që klasifikohen si në listat vijuese:</p> <p>Lista III.A.: bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera, hyrja e të cilave në Kosovë duhet të ndalohet;</p> <p>Lista III.B.: bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera, hyrja e të cilave duhet të ndalohet në zonat e veçanta të mbrojtura;</p> <p>Lista IV.A.: bimë, produktet bimore dhe objekte të tjera të cilat duhet të plotësojnë kërkesat specifike fitosanitare të vendosura për import dhe qarkullim në Kosovë;</p> <p>Lista IV.B.: bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera të cilat, duhet të plotësojnë kërkesat e veçanta të vendosura për hyrjen dhe qarkullimin në dhe brenda disa zonave të mbrojtura.</p> <p>Lista V.A.: bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera të prodhuara në</p>	<p>Kosovo shall be prohibited, if they are present on certain plants or plant products even if their occurrence is known to occur in the country.</p> <p style="text-align: center;">Article 8 List plant consignments regulated by this law</p> <p>1. Plants, plant products and other objects which carry harmful organisms substantially endangering plant health and whose introduction and spread in the country shall be regulated by this Law are divided in the following lists:</p> <p>List III.A.: plants, plant products and other objects, the introduction of which in Kosovo shall be prohibited;</p> <p>List III.B.:—plants, plant products and other objects, the introduction of which shall be prohibited in special protected zones;</p> <p>List IV.A.: plants, plant products and other objects, which shall satisfy special phytosanitary requirements laid down for import and transfer in Kosovo;</p> <p>List IV.B.: plants, plant products and other objects which shall satisfy special requirements laid down for the introduction and movement into and within certain protected zones.</p> <p>List V.A.: plants, plant products and other objects, produced in Kosovo,</p>	<p>zabraniti ako su prisutni na neke biljke ili biljnih proizvoda i ako je njihovo prisustvo zemlji poznato.</p> <p style="text-align: center;">Član 8 Lista biljnih pošiljka regulisanim ovim zakonor</p> <p>1. Biljke, biljni proizvodi i drugi objekti koji su nosioci štetnih organizama koji ugrožavaju zdravlje biljaka čije unošenje I širenje u zemlji treba regulisati zakonom I koje se klasifikuju na sledećim listama:</p> <p>Lista III.A.: bilje, biljni proizvodi I drugi objekti čije unošenje na Kosovu treba zabraniti;</p> <p>Lista III.B.: bilje, biljni proizvodi i drugi objekti čije unošenje na Kosovu treba zabraniti na posebnim zaštićenim zonama;</p> <p>Lista IV.A.: bilje, biljni proizvodi i drugi objekti koje treba da ispune postavljene specifične fitosanitarne zahteve za uvoz i promet na Kosovu;</p> <p>Lista IV.B.: biljke, biljni proizvodi i drugi objekti koji treba da ispunjavaju specifične sanitarne zahteve postavljenim za unošenje i promet u i unutar nekih zaštićenih zona;</p> <p>Lista V.A.: biljke, biljni proizvodi i drugi objekti proizvedeni na</p>
--	--	---

<p>Kosovë, të cilat janë bartës potencialë të organizmave të dëmshëm relevant për vendin dhe që duhet të shoqërohen me një pasaportë bimore për të qarkulluar në gjithë territorin e Kosovës.</p> <p>Lista V.A.I: bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera që vijnë nga vende të tjera, të cilat janë bartës potencialë të organizmave të dëmshëm relevant për vendin tonë dhe ato duhet të shoqërohen me certifikatë fitosanitare.</p> <p>Lista V.B.: Bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera të cilët janë bartës potencialë të organizmave të dëmshëm relevant për disa zona të mbrojtura dhe të cilat duhet të shoqërohen me një pasaportë bimore të vlefshme për një zonë të caktuar kur futen apo qarkullojnë brenda asaj zone.</p> <p>2.Listat sipas neneve 7 dhe 8 të këtij ligji duhet të vendosen në anekse të veçanta që janë pjesë përbërëse e këtij ligji, për veç listës I.B në nenin 7 dhe IV.B dhe VB në nenin 8, të cilat ju referohen kërkesave speciale për zonat e mbrojtura, përbërja e të cilave përcaktohet në akte nënligjore përkatëse.</p> <p style="text-align: center;">Neni 9</p> <p style="text-align: center;">Kërkesat për raportim për organizmat e dëmshëm karantinorë</p> <p>1. Kur në Kosovë shfaqen organizma të</p>	<p>which are potential carriers of harmful organisms of relevance for the country and which must be accompanied by a plant passport for the transfer in the entire territory of Kosovo;</p> <p>List V.A.I:—plants, plant products and other objects, coming from other countries, which are potential carriers of harmful organisms of relevance for our country and which must be accompanied by a phytosanitary certificate.</p> <p>List V.B.: Plants, plant products and other objects, which are potential carriers of harmful organisms of relevance for certain protected zones, and which must be accompanied by a plant passport valid for the appropriate zone when introduced into or moved within that zone.</p> <p>2. Lists under the articles 7 and 8 of this law shall be contained in specific annexes, which are integral part of this Law, except for list I.B in Art. 7 and IV.B and V.B in Art. 8 which refers to special requirements for protected zones, whose content will be defined in dedicated sub-legal acts.</p> <p style="text-align: center;">Article 9</p> <p style="text-align: center;">Reporting requirement for quarantine pests</p> <p>1. When harmful organisms of the Lists</p>	<p>Kosovu koji su potencijalni nosioci štetnih organizama relevantnim za zemlju koja treba da imaju biljni pasoš radi prometa na čitavoj teritoriji Kosova</p> <p>Lista V.A.I.: biljke, biljni proizvodi i drugi objekti koji dolaze iz drugih zemalja koji su nosioci potencijalnih štetnih organizama relevantnim za našu zemlju treba da imaju fitosanitarno uverenje.</p> <p>Lista V.B.: biljke, biljni proizvodi i drugi objekti koji su potencijalni nosioci štetnih organizama, relevantnim za neke zaštićene zone i koje treba da budu snabdeveni važećim biljnim pasošem za određenu zonu kada se unose ili se stavljaju u promet na toj zoni.</p> <p>2.Liste iz člana 7.i 8. ovog zakona treba da se postavljaju u posebnim aneksima koji su sastavni deo ovog zakona, osim liste I:B u članu 7. i IV.B i VB u članu 8. koja se odnose na specijalne zahteve za zaštićene zone čiji sastav se utvrđuje odgovarajućim pod zakonskim aktima.</p> <p style="text-align: center;">Član 9</p> <p style="text-align: center;">Zahtevi za raportiranje o karantinskim štetnim organizmima</p> <p>1. Kada se na Kosovu pojave štetni</p>
--	--	--

<p>dëmshëm të përcaktuara sipas Listave I.A. I.A.1 dhe II.A.1 për gjithë territorin e Kosovës dhe të Listës I.B. për zonat e mbrojtura, ose kur në bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera shfaqen simptoma që vendosin dyshime për praninë e të njëjtave organizmave të dëmshëm, prodhuesit bujqësorë dhe zyrtarët publik të ngarkuar me mbrojtjen e bimëve duhet të lajmërojnë menjëherë inspektionin fitosanitar dhe organin kompetent.</p> <p>2.Prodhuesi bujqësor duhet të mbrojë bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera në përputhje me udhëzimet e përcaktuara nga Inspektorët fitosanitarë.</p> <p>3.Ministria me akt nënligjor e përcakton mënyrën e lajmërimit.</p>	<p>I.A, I.A.1, II.A and II.A.1 for the entire territory of Kosovo and the List I.B for the protected zones or symptoms that raise suspicions on the occurrence of the same harmful organisms appear in plants, plant products and other objects, producers in agriculture and Public officers charged in plant protection must immediately and consistently inform the phytosanitary inspectorate and the competent organ.</p> <p>2. The producer in agriculture shall protect plants, plant products and other objects in accordance with the instructions designated by the phytosanitary inspectors.</p> <p>3.The method of informing shall be designated by the Ministry in a sub-legal act.</p>	<p>organizmi utvrđeni prema Listi I.A. I.A.1.i A.1.za čitavu teritoriju Kosova i Liste I.B. za zaštićene zone ili kada na biljke, biljne proizvode i druge objekte pojave simptomi koji postiću sumnje o prisustvu istih štetnih organizama, poljoprivedni proizvođači i javni zvaničnici zaduženi za zaštitu bilja treba da odmah obaveste fitosanitarnu inspekciju i nadležni organ.</p> <p>2.Poljoprivedni proizvođači treba da zaštite biljke, biljne proizvode i druge objekte u skladu sa uputstvima utvrđenim od strane fitosanitarnih inspektora.</p> <p>3.Ministarstvo pod zakonskim aktom utvrđuje način obaveštenja.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 10 Laboratori referent fitosanitar</p> <p>1. Kur dyshohet për praninë e organizmave të dëmshëm, inspektori fitosanitar mund të marrë dhe dërgojë disa mostra reprezentative për analiza të mëtejshme në laboratorin fitosanitar për diagnostikimit të parazitëve në Institutin Bujqësor të Kosovës si dhe laboratore tjerë të akredituar.</p> <p>2.Laboratorin fitosanitar për diagnostikimit të parazitëve në Institutin Bujqësor të Kosovës si dhe laboratorë tjerë të akredituara:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1 përdor metodat e duhura për</p>	<p style="text-align: center;">Article 10 Phytosanitary referent laboratory</p> <p>1. When the presence of harmful organisms is suspicious, the phytosanitary inspector may take and send some representatives' samples for further analyses to the phytosanitary laboratory on diaganstification of parasites to the Kosovo Agriculture Institute as well as other accredited laboratories.</p> <p>2.Phytosanitary laboratory on diaganstification of parasites to the Kosovo Agriculture Institute as well as other accredited laboratories:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1 uses appropriate methods on</p>	<p style="text-align: center;">Član 10 Referentni fitosanitarni laborator</p> <p>1. Dada se sumnja na prisustvo štetnih organizma, fitosanitarni inspektor može uzeti i postati nekoliko reprezentativne uzorke na dalju analizu u fitosanitarni laborator za dijagnoztifikaciju parazita u Poljoprivrednom Institutu Kosova i u drugim akreditovanim laboratorijama.</p> <p>2.Fitosanitarnom laboratoru za dijagnostifikaciju parazita u Poljoprivrednom Institutu Kosova i druge akreditovane laboratorike:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1 da primeni metode za tretiranje i</p>

<p>trajtimin dhe ruajtjen e mostrave të organizmave të dëmshëm duke parandaluar rrezikun e përhapjes së tyre, provon praninë e tyre, mbanë evidencën e mostrave dhe paraqet rregullisht shënimet mbi analizat;</p> <p>2.2 nëse konstatohen organizma të dëmshëm të përfshira në Listat I.A., I.A.1, II.A., II.A.1 apo në Listën I.B, .B. dhe II.B. njofton menjëherë organin kompetent, i cili nga ana e tij informon prodhuesit bujqësorë dhe subjekte të tjera për shfaqjen e organizmave të dëmshëm dhe rrezikun e tyre dhe i këshillon për veprimet dhe masat paraprake që duhet të merren.</p>	<p>sample manipulation and conservation of harmful organisms preventing the risk of their spread, proves their occurrence, keeps sample evidence, regularly maintains and presents notes on analysis;</p> <p>2.2 if harmful organisms included in Lists I.A, I.A.1, II.A., II.A.1, or List I.B. and II.B are detected, it immediately informs the Competent organ, which in turn informs producers in agriculture and other subjects on the occurrence of harmful organisms and their risk and advices them on the preliminary actions and measures to be taken.</p>	<p>čuvanje uzorka štetnih organizama radi sprečavanja rizika od širenja štetnih organizama, utvrđuje njihovo prisustvo, vodi evidenciju uzoraka, čuva i redovno prezentira podatke o i analizama;</p> <p>2.2 ukoliko konstatuje prisustvo štetnih organizama iz Liste I.A, I.A.1., II.A.1. ili Liste I.B.,B i II.B., odmah obavesti nadležni organ koji sa svoje strane informiše poljoprivredne proizvođače i druge subjekte o pojavi štetnih organizama i o njihovom riziku i savetuje o aktivnostima i prethodnim merama koje treba preduzeti.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 11 Mbajtja e Shënimeve për organizmat e dëmshëm</p> <p>1.Organi kompetent mban evidencë në mënyrë të rregullt dhe i ruan të gjitha shënimet lidhur me shfaqjen e organizmave të dëmshëm në vend për të pasur e siguruar të dhëna të sakta me interes kombëtar dhe ndërkombëtar.</p> <p>2. Ministria, me akt nënligjorë e përcakton përmbajtjen, formën dhe mënyrën e mbajtjes së shënimeve për:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1 identifikimin e organizmave të rinj të dëmshëm të Listave I.A. dhe II.A. në Kosovë, të cilat mund të</p>	<p style="text-align: center;">Article 11 Harmful organisms Records</p> <p>1.The competent organ regularly keeps evidence and maintains all the records regarding the occurrence of harmful organisms in the country in order to possess and provide accurate information of national and international interest.</p> <p>2. The Ministry designates in sub-legal acts the content, format and method of record keeping for:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1 identification of new harmful organisms presented in List I.A and II.A in Kosovo, which can be</p>	<p style="text-align: center;">Član 11 Vodenje podataka o štetnim organizmima</p> <p>1.Nadležni organ vodi evidenciju na uredan način i čuva sve podatke o pojavi štetnih organizama i druge neophodne podatke u vezi praćenja štetnih organizama, u cilju raspolaganja poverljivim podacima koji mogu biti od nacionalnog i međunarodnog interesa.</p> <p>2.Ministarstvo, pod zakonskim aktima utvrđuje formu i način vođenja evidencije radi:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. identifikacije novih štetnih organizama iz Liste I.A. i II.A. na Kosovu, koja se mogu uredno</p>

<p>shpallën rregullisht, 2.2 shpalljen e të dhënave për identifikimin e ri të organizmave të dëmshëm të Listave I.A. dhe II.A.</p> <p style="text-align: center;">Neni 12 Zonat e rregulluara me këtë ligj</p> <p>1.Nëse vërtetohet prania e organizmave të dëmshëm dhe ka rrezik për përhapjen e tyre në zonën e rregulluar me këtë ligj, inspektori fitosanitar:</p> <p>1.1 jep të dhëna për vendndodhjen e tyre dhe urdhëron marrjen e masave fitosanitare të përcaktuara nga organi kompetent;</p> <p>1.2 në varësi të llojit të organizmave të dëmshëm njofton rregullisht prodhuesit bujqësorë për vendin e shfaqjes së tyre.</p> <p>2. Ministria, me akt nënligjor përcakton kufijtë e territorit nën mbikëqyrje, masat që duhet të merren për identifikimin dhe parandalimin e përhapjes së organizmave të dëmshëm, dhe masat që merren në pajtim me nenin 44 të këtij ligji.</p>	<p>regularly launched. 2.2 the launch of data on the new identification of harmful organisms presented in List I.A and II.A.</p> <p style="text-align: center;">Article 12 Regulated area with this law</p> <p>1.If the occurrence of harmful organisms is verified and exists the risk for their spread in the regulated area in this law, the phytosanitary inspector:</p> <p>1.1 gives data on the occurrence location and orders the initiation of the phytosanitary measures designated by the Competent Organ;</p> <p>1.2 depending on the type of harmful organisms regularly informs the-producers in agriculture on the location of the occurrence.</p> <p>2. The Ministry designates in legal acts the borders of the territory under supervision, measures to be taken for the identification and prevention of harmful organisms spreading, and measures to be taken, according to what established in the art. 44 of this law.</p>	<p>objavljivati; 2.2. objavljivanja podataka o novoj identifikaciji štetnih organizama iz Liste I.A. i II.A.</p> <p style="text-align: center;">Član 12 Zone regulisane zakonom</p> <p>1.Ako se utvrdi prisustvo štenih organizama i preti opasnost za njihovo širenje u zoni regulisanim ovim zakonom, fitosanitarni inspektor:</p> <p>1.1. daje podatke o mestu gde se iste nalaze i naređuje preduzimanje fitosanitarnih mera od strane nadležnog organa;</p> <p>1.2.zavisno od vrste štenih organizama, izveštava na uredan način proizvođače bilja o mestu njihove pojave.</p> <p>2. Ministarstvo pod zakonskim aktom utvrđuje granice teritorije pod posebnim nadzorom, mere za identifikaciju, sprečavanje i širenje štetnih organizama i mere koja se preduzimaju u skladu sa članom 44. ovog zakona</p>
<p style="text-align: center;">Neni 13 Zonat e mbrojtura</p> <p>1.“Zonë e mbrojtur” është një zonë e vendit e njohur zyrtarisht nga Organi Kompetent, në të cilin:</p>	<p style="text-align: center;">Article 13 Protected zones</p> <p>1. A “protected zone” is an area of the country, officially recognized by the Competent organ, in which:</p>	<p style="text-align: center;">Član 13 Zaštićene zone</p> <p>1.„Zaštićena zona“ je zona zemlje zvanično priznata od strane Nadležnog organa, u kojoj:</p>

<p>1.1 një apo më shumë organizma të dëmshëm që përmenden në këtë ligj, të cilët gjenden në një apo më shumë zona të vendit apo të vendeve fqinje, nuk janë endemike apo të pranishme, pavarësisht nga kushtet e favorëshme për të qenë të pranishme.</p> <p>1.2 ka rrezik që disa organizma të dëmshëm, në saje të kushteve ekologjike të përshtatshme, të vendosen në kultura të caktuara pavarësisht faktit se këta organizma nuk janë endemike apo të pranishme në vend.</p> <p>2.Një organizëm i dëmshëm do të konsiderohet i vendosur në një zonë për këtë arsye ajo e humb statusin e zonës së mbrojtur nëse konstatohet prania e tij dhe nëse atje nuk janë marrë masa zyrtarisht për zhdjekjen e tij ose këto masa janë treguar të pa-efektëshme për një periudhë të paktën dyvjeçare.</p> <p>3.Në zonat e shpallura zona të mbrojtura, inspektorët fitosanitarë duhet të kryejnë mbikëqyrje zyrtare sistematike dhe të rregullta për praninë e organizmave të dëmshëm lidhur me të cilët është njohur si zonë e mbrojtur.</p> <p>4.Ministria me akt nënligjor e përcakton shpalljen e zonave të mbrojtura, listat e organizmave të dëmshëm të përfshira, kushtet për mbikëqyrjen sistematike të tyre dhe qarkullimin e bimëve, produkteve</p>	<p>1.1 one or more harmful organisms referred to in this law, which are established in one or more parts of the country or neighboring countries, are not endemic or established despite favorable conditions for them to establish themselves there.</p> <p>1.2 there is a danger that certain harmful organisms will establish, given propitious ecological conditions, for particular crops, despite the fact that these organisms are not endemic or established in the Country.</p> <p>2.A harmful organism shall be considered to be established in an area (therefore the status of protected zone is lost) if it is ascertained their presence and if either no official measures have been taken there with a view to its eradication or such measures have proved, for a period of at least two successive years, to be ineffective.</p> <p>3.In zones proclaimed as protected zones, the phytosanitary inspectors must conduct regular and systematic official surveys on the presence of harmful organisms in respect of which the protected zone has been recognized.</p> <p>4.The proclamation of protected zones, the lists of harmful organisms involved the conditions for their systematic surveillance and of circulation of plants, plant products and other objects within these zones is</p>	<p>1.1. jedan ili više štetnih organizama koji se spominju u ovom zakonu, koji se nalaze u jednoj ili više zone zemlje ili u susednim zemljama nisu endemične ili prisutne bez obzira na povoljne uslove da budu prisutni.</p> <p>1.2. postoji rizik da neki štetni organizmi zahvaljujući povoljnim ekološkim uslovima, smeste na određenim kulturama, bez obzira što ovi organizmi nisu endemični ili prisutni u zemlji.</p> <p>2.Štetni organizam smatraće se postavljenim u zoni i zbog toga zona gubi status zaštićene zone ako se konstatuje prisustvo tog organizma i ako tamo nisu preduzete zvanične mere za njegovo suzbijanja ili ako su ove mere nisu pokazane efektivnim za neprekidni period od najmanje dve godine.</p> <p>3.U proglašenim zaštićenim zonama, fitosanitarni inspektori treba da obavljaju sistematski i redovni službeni nadzor o prisustvu štetnih organizama po kojima zaštićena zona je poznata.</p> <p>4.Pod zakonskim aktom Ministarstvo utvrđuje proglašenje zaštićenih zona, liste obuhvaćenih štetnih organizama i promet bilja, biljnih proizvoda i drugih objekta unutra zaštićene zone.</p>
---	--	---

bimore dhe objekteve të tjera, brenda zonës së mbrojtur.

KREU IV

NDALESAT DHE KUFIZIMET PËR HYRJEN DHE PËRHAPJEN E ORGANIZMAVE TË DËMSHËM NË BIMË

Neni 14

Ndalimi i hyrjes së organizmave të dëmshëm

1.Ndalohet hyrja dhe përhapja e organizmave të dëmshëm të përfshira në Listat I.A., I.A.1, II.A. dhe II.A.1 në gjithë territorin e Kosovës.

2.Ndalohet hyrja dhe përhapja e organizmave të dëmshëm të përfshira në Listën I.B. në zonat e mbrojtura.

3.Hyrja dhe përhapja e organizmave të dëmshëm të cilët nuk përfshihen në Listat sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, gjithashtu janë të ndaluara nëse rrezikojnë shëndetin e bimëve në territorin e Kosovës.

Neni 15

Ndalesat e mallrave të importit

1. Në territorin e Kosovës ndalohet importi

designated by the Ministry in sub-legal acts.

CHAPTER IV

PROHIBITIONS AND RESTRICTIONS TO THE INTRODUCTION AND SPREAD OF HARMFUL ORGANISMS TO PLANTS

Article 14

Prohibition of harmful organisms introduction

1.The introduction and spread of harmful organisms present in the Lists I.A, I.A.1, II. A. and II.A.1 is prohibited in the entire territory of Kosovo.

2.The introduction and spread of harmful organisms included in List I.B is prohibited in the protected zones.

3.The introduction and spread of harmful organisms not included in the Lists under paragraph 1 and 2 of this article, is also prohibited if these endanger plant health in the territory of Kosovo.

Article 15

Prohibition of commodities import

1. The import of plants, plant products and

POGLAVLJE IV

ZABRANE I OGRANIČENJA UNOŠENJA I ŠIRENJA ŠTETNIH ORGANIZAMA NA BILJKE

Član 14

Zabrana ulaska štetnih organizma

1.Zabranjuje se unošenje i širenje štetnih organizama iz Liste I.A.; I.A.1, II.A. i II.A.1na teritoriji Kosova.

2.Zabranjuje se unošenje i širenje štetnih organizama iz Liste I.B. na zaštićene zone.

3.Unošenje I širenje štetnih organizama koji nisu obuhvaćeni Listama iz stava 1 i 2 ovog člana, takođe je zabranjeno ukoliko ugrožavaju zdravlje bilja na teritoriji Kosova.

Član 15

Zabrana robe iz uvoza

1. Zabranjuje se uvoz biljaka, biljnih

<p>i bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera të përcaktuara në Listën III.A.</p> <p>2. Në zonat e mbrojtura ndalohet importi i bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera të përfshira në Listën III.B.</p> <p>3. Ndalohet importi dhe qarkullimi i bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera të përfshira në Listën IV.A, nëse nuk janë zbatuar masat e përcaktuara fitosanitare.</p> <p>4. Ndalohet importi dhe qarkullimi i bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera të përfshira në Listën IV.B., në territoret e shpallura zona të mbrojtura, nëse nuk janë zbatuar masat e përcaktuara fitosanitare.</p> <p>5. Ministria me akt nënligjor e përcakton importin dhe qarkullimin e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera të përfshira në listat sipas paragrafëve 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni, nëse ato përbëjnë rrezik për shëndetin e bimëve në territorin e Kosovës.</p>	<p>other objects specified in List III.A is forbidden in the territory of Kosovo.</p> <p>2. The import of plants, plant products and other objects included in List III.B is prohibited in protected zones.</p> <p>3. The import and transfer of plants, plant products and other objects included in List IV.A is prohibited if the designated phytosanitary measures are not satisfied.</p> <p>4. The import and transfer of plants, plant products and other objects included in List IV.B is prohibited in territories proclaimed as protected zones if the designated phytosanitary measures are not satisfied.</p> <p>5. The import and transfer of plants, plant products and other objects included in the lists under paragraph 1, 2, 3 and 4 of this article is prohibited by the Ministry in a sub-legal act if these endanger plant health in the territory of Kosovo.</p>	<p>proizvoda i drugih objekata iz Liste III.A. na teritoriji Kosova.</p> <p>2. Zabranjuje se uvoz biljaka, biljnih proizvoda i drugih objekata iz Liste III.B., u zaštićenim zonama.</p> <p>3. Zabranjuje se uvoz i promet biljaka, biljnih proizvoda i drugih objekata iz Liste IV.A., ukoliko nisu sprovedene utvrđene fitosanitarne mere.</p> <p>4. Zabranjuje se uvoz i promet biljaka, biljnih proizvoda, drugih objekata iz Liste IV.B., na teritorijama koja su proglašene zaštićenim zonama, ukoliko nisu sprovedene utvrđene fitosanitarne mere.</p> <p>5. Pod zakonskim aktom Ministarstvo utvrđuje promet biljaka, biljnih proizvoda i drugih objekata obuhvaćenim listama prema stavovima 1, 2, 3 i 4 ovog člana, ukoliko predstavljaju opasnost po zdravlje biljka na teritoriji Kosova.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 16 Hyrja dhe bartja e materialit për hulumtim shkencor apo për qëllim seleksionim klonal</p> <p>1. Me përjashtim të dispozitave të nenit 14 dhe 15 të këtij Ligji, personat juridikë që merren me veprimtari shkencore-hulumtuese, mund të importojnë ose qarkullojnë organizma të dëmshëm të</p>	<p style="text-align: center;">Article 16 Introduction and transfer of material for scientific research or clonal selection aim</p> <p>1. In exception to the provisions of article 14 and 15 of this Law, legal entities which deal with scientific research activities, may import or transfer harmful organisms included in List I.A., I.A.1., II.A., II.A.1,</p>	<p style="text-align: center;">Član 16 Unošenje i prevoz materijala za naučno istraživanje ili u cilju klonirajuće selekcije</p> <p>1. Izuzev odredba člana 14. i 15. ovog Zakona, pravna lica koji se bave naučno-istraživačkim aktivnostima mogu uvoziti ili staviti u promet štetne organizme obuhvaćenim u Listama I.A.1, II.A,</p>

<p>përfshira në Listat I.A., I.A.1, IIA, II.A.1, I.B. dhe bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera të paraqitura në Lista III.A., III.B., IV.A. dhe IV.B., në qoftë se:</p> <p>1.1 janë të pajisur me leje për import;</p> <p>1.2 i përdorin ato për ekzaminime, hulumtime ose për punë seleksionuese të bimëve;</p> <p>1.3 plotësojnë kushtet e parapara përsa i përket aftësisë profesionale dhe teknike, të përcaktuara nga organi kompetent.</p> <p>2.Lejet sipas paragrafit 1 të këtij neni, lëshohen nga organi kompetent i Ministrisë në bazë të kërkesës së bërë nga personi juridik shkencor.</p> <p>3. Kërkesa, duhet të përmbajë:</p> <p>3.1 të dhëna për paraqitësin e kërkesës;</p> <p>3.2 të dhëna mbi organizmat e dëmshëm të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera sipas paragrafit 1 të këtij neni.</p> <p>3.3 vendin e origjinës dhe prejardhjen e materialit;</p> <p>3.4 objektivat e eksperimentit shkencor ose të punës seleksionuese klonale dhe kohëzgjatjen;</p> <p>3.5 vendin ku kryhet eksperimenti me përshkrimin e pajisjeve e mjeteve karantinore;</p> <p>3.6 metodën që përdoret për asgjësimin apo trajtimin e</p>	<p>I.B. and plants, plant products and other objects presented in List III.A., III.B., IV.A. and IV.B., if:</p> <p>1.1 they possess the import permit;</p> <p>1.2 they use these for examinations, researches or plant selection activities;</p> <p>1.3 they satisfy the conditions foreseen for their professional and technical capacities, designated by the competent organ.</p> <p>2.Permits under paragraph 1 of this article are issued by the competent organ of the Ministry on the request made by the scientific legal entity.</p> <p>3. The enquiry shall include:</p> <p>3.1 data on the enquirer;</p> <p>3.2 data on the harmful organisms to plants, plant products and other objects under paragraph 1 of this article;</p> <p>3.3 the place of origin and provenience of the material;</p> <p>3.4 the objectives of the scientific experiment or of the clonal selection work and its duration;</p> <p>3.5 the place where the experiment will be conducted, with the description of quarantine facilities;</p> <p>3.6 the method that will be used for the destruction or treatment of the</p>	<p>II.A.1, I.B. i biljke, biljnih proizvoda i druge objekte obuhvaćenim Listama III.A., III.B., IV.A. i IV.B., ukoliko:</p> <p>1.1. su snabdevena dozvolom o uvozu;</p> <p>1.2. koriste njih za ispitivanja, istraživanja i za poslove biljnih selekcija;</p> <p>1.3. ispunjavaju predviđene uslove što se tiče stručne i tehničke sposobnosti utvrđenim od strane nadležnog organa.</p> <p>2.Dozvole prema stavu 1. ovog člana izdaju se od strane nadležnog organa Ministarstva na osnovu zahteva naučnog pravnog lica.</p> <p>3.Zahtev treba da sadrži:</p> <p>3.1.podatke o podnosiocu zahteva;</p> <p>3.2.podatke o štetnim biljnim organizmima, biljnih proizvoda i drugih objekata prema stavu 1. ovog člana.</p> <p>3.3.zemlju porekla i poreklo materijala;</p> <p>3.4.objektive naučnog eksperimenta ili klonirajući selekcijski rad i trajanje;</p> <p>3.5.mesto gde se eksperiment obavlja uz opis opreme i karantinskih sredstva;</p> <p>3.6.metodu koja se koristi radi uništenju ili tretiranju materijala</p>
--	--	---

<p>materialit pas përfundimit të eksperimentit.</p> <p>4. Organi kompetent mban evidencë për importin e bimëve sipas paragrafit 3 nënparagrafi 3.2 të këtij neni.</p> <p>5. Në momentin e hyrjes së materialit inspektori fitosanitar verifikon nëse ai është në përputhje me materialin e kërkuar dhe nëse janë të gjitha dokumentet e nevojshëm si: certifikata e origjinës dhe leja e importit e lëshuar nga organi kompetent.</p> <p>6. Bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera të cilat gjatë masave të përmendura rezultojnë të infektuara nga organizmat e dëmshëm të treguar në paragrafin 1 të këtij neni dhe gjithë bimët, produktet bimore dhe objekte të tjera me të cilat kanë qenë në kontakt ose mund të jenë kontaminuar, duhet të asgjësohen ose të trajtohen në pajtim me rekomandimet e paraqitura nga inspektori fitosanitar.</p> <p>7. Për ndonjë material, përfshirë organizmat e dëmshme dhe mbase ndonjë material tjetër i cili mund të jetë kontaminuar gjatë provave, kur përfundojnë aktivitetet e miratuara, inspektori fitosanitar duhet të sigurojë që:</p> <p>7.1 materiali, si dhe organizmat e dëmshëm dhe materialet që mund të jenë kontaminuar dhe gjithë bimët, produktet bimore ose produkte të tjera me të cilat kanë qenë në kontakt ose mund të jenë kontaminuar, duhet të asgjësohen, sterilizohen apo t'u nënshtrohen trajtimeve të duhura;</p>	<p>material after the experiment is concluded;</p> <p>4. The competent organ keeps evidence on the import of plants under paragraph 3 point sub paragraph 3.2 of this Article.</p> <p>5. At the time of introduction of material the phytosanitary inspector verifies that the material is correspondent to that requested and that all the necessary documents are present, i.e. certificate of origin and import permission issued by the Competent organ.</p> <p>6. The plants, plant products and other objects that during the cited measures result infected by harmful organisms indicated in paragraph 1, of this article and all plants, plant products and other objects with which they were in contact or may have been contaminated, should be destroyed or opportunely treated, according the recommendations provided by the phytosanitary inspector.</p> <p>7. For any material, including harmful organisms and any other eventually contaminated material during the proof, when the approved activities are finished the phytosanitary inspector shall ensure that:</p> <p>7.1 the material, as well as pests and the possible contaminated material, and all the plants, plant products or other products with which it has been in contact, or can have been contaminated shall be destroyed, sterilized or subjected to appropriate</p>	<p>nakon okončanja eksperimenta.</p> <p>4. Nadležni organ vodi evidenciju o uvozu biljka prema stavu 3. pod stav 3.2. ovog člana.</p> <p>5. U momentu unošenja materijala, fitosanitarni inspektor utvrđuje da li je materijalu sklada sa traženim materijalom i dali su svi potrebni dokumenti kao što su: vrenje o poreklu i dozvola o uvozu izdata od strane nadležnog organa.</p> <p>6. Bilje, biljni proizvodi i drugi objekti koja tokom pomenutih mera rezultiraju da su zaražena od štetnih organizama spomenutih u stavu 1. ovog člana i sve biljke, biljni proizvodi i dugi objekti sa kojima je bilo u kontaktu ili su kontaminirani, treba uništiti ili tretirati na osnovu preporuka fotosanitarnog inspektora.</p> <p>7. Za materijal uključujući i štetne organizme ili drugi materijal koji mogu biti kontaminirani tokom opita, kad se usvojeni aktivnosti završe, fitosanitarni inspektor treba da obezbedi sledeće:</p> <p>7.1. materijal uključujući i štetne organizme ili drugi materijal koji mogu biti kontaminirani i sve biljke, biljni proizvodi i dugi objekti sa kojima je bilo u kontaktu ili su kontaminirani, treba uništiti sterilizirati ili</p>
---	---	--

<p>7.2 mjediset dhe mjetet ku janë kryer veprimtaritë, duhet të sterilizohen ose të pastrohen.</p> <p>8.Ministria me akt nënligjor e përcakton kërkesat për aftësi profesionale dhe teknike, përmbajtjen dhe formularin e lejes për importin e bimëve dhe produkteve të tjera.</p> <p style="text-align: center;">Neni 17 Përrjashtimet në importin e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera</p> <p>1.Me përjashtim të dispozitave të neneve 14 dhe 15 të këtij Ligji, organi kompetent në pajtim me kërkesat e përcaktuara dhe nëse vlerëson se nuk ka rreziku për përhapjen e organizmave të dëmshëm, në raste të veçanta mund të lejojë importin e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera të cilat kultivohen ose përdorën për nevoja personale dhe destinohen për mbjellje ose për përdorim personal të menjëhershëm.</p> <p>2.Organi kompetent mban shënime për importin e lejuar sipas paragrafit 1 të këtij neni.</p> <p style="text-align: center;">Neni 18 Dispozita të veçanta për hyrjen ose qarkullimin e dërgesave bimore</p> <p>1.Dispozitat e nenit 14 dhe 15 të këtij Ligji nuk janë të zbatueshme nëse:</p>	<p>treatment;</p> <p>7.2. the premises and facilities where the activities took place are sterilized or appropriately cleaned.</p> <p>8.The Ministry designates in a sub-legal act the requirements of the professional and technical capacity, the detailed content and the format of the import permit for plant and other products.</p> <p style="text-align: center;">Article 17 Exceptions to the importation of plants, plant products and other objects</p> <p>1.Except for the provisions of articles 14 and 15 of this Law, the competent organ, in compliance with the designated requirements and if it assesses that there is no risk of harmful organisms spreading, in special cases may permit the import of plants, plant products and other objects grown or used for personal needs which are intended for planting or for immediate personal use.</p> <p>2.The competent organ keeps evidence on the import permitted under paragraph 1 of this article.</p> <p style="text-align: center;">Article 18 Special provisions for plant consignment introduction or transfer</p> <p>1.Provisions of Article 14 and 15 of this Law are not applicable if:</p>	<p>odležati valjanim procedurama;</p> <p>7.2.sredine i sredstva gde su se aktivnosti odvijali, treba sterilizovati i očistiti.</p> <p>8.Ministarstvo pod zakonskim aktom utvrđuje uslove za stručnu i tehničku sposobnost, sadržinu i obrazac dozvole za uvoz bilja i dugih proizvoda.</p> <p style="text-align: center;">Član 17 Izuzetci u uvozu bilja, biljnih proizvoda i drugih objekata</p> <p>1.Izuzev odredba člana 14. i 15. ovog Zakona, nadležni organ u skladu sa utvrđenim zahtevima i ukoliko proceni da ne postoji opasnost za širenje štetnih organizama, u posebnim slučajevima može dozvoliti uvoz bilja, biljnih proizvoda i drugih objekata koji se uzgajaju ili se koriste za lične potrebe i namenjena su setvi ili za trenutnu ličnu potrebu.</p> <p>2.Nadležni organ vodi podatke za dozvoljeni uvoz prema stavu 1. ovog člana.</p> <p style="text-align: center;">Član 18 Posebne odredbe za unošenje i promet biljnih pošiljka</p> <p>1.Odredbe člana 14. i 15. ovog Zakona sprovodljive su ukoliko:</p>
--	---	--

<p>1.1 dërgesa bimore është në tranzit në Kosovë;</p> <p>1.2 sasi të vogla të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera, përfshirë artikuj ushqimorë dhe ushqim për kafshë, të destinuara për përdorim personal, industrial ose jo komerciale ose për ushqimin e kafshëve gjatë transportit.</p> <p>2.Sasi të vogla sipas paragrafit 1 nënparagrafi 1.2 e këtij neni duhet të zbatohen për: fryte të freskëta dhe perime, përveç patateve, lule të prera dhe buqeta, farëra në paketim origjinal, përveç farës së patates, rizoma të bimëve dekorative, pjesëve të prera të drurëve halorë - pa rrënjë për festime të ndryshme dhe lule në saksitë të destinuara vetëm për nevojat e përdoruesve të fundit.</p> <p>3. Ministra me akt nënligjor e përcakton sasi të vogla të bimëve sipas këtij neni.</p> <p style="text-align: center;">KREU V</p> <p style="text-align: center;">REGJISTRI I PRODHUESVE TË BIMËVE, PAKETUESVE, PËRPUNUESVE, IMPORTUESVE, SHPËRNDARËSVE DHE DEPUNUESVE</p> <p style="text-align: center;">Neni 19 Kërkesat për regjistrim</p>	<p>1.1 the plant consignment is in transit in Kosovo;</p> <p>1.2 small quantities of plants, plant products and other objects, including food and feed commodities, are intended for personal, industrial or non-commercial use or feeding during transport.</p> <p>2.Small quantities under paragraph 1 point subparagraph 1.2 of this article shall be applied to: fresh fruit and vegetables, other than potato; cut flowers and bouquets; seeds in original packaging, other than potato seed; decorative plant rhizomes, cut stalks of coniferous trees - without roots needed for different celebrations and flowers in pots exclusively intended for the needs of final users.</p> <p>3. Small quantities under this article are defined by the Ministry in a sub-legal act.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER V</p> <p style="text-align: center;">REGISTER OF NURSERYMEN, PACKAGING, PROCESSORS, IMPORTERS, DISTRIBUTORS AND STORING PEOPLE</p> <p style="text-align: center;">Article 19 Registration requirements</p>	<p>1.1. pošiljka biljaka je u tranzitu kroz Kosovo;</p> <p>1.2. manje količine biljaka, biljnih proizvoda i drugih objekata, uključujući prehrambene artikle i hranu za životinje, namenjenih za ličnu upotrebu, za industrijsku namenu a ne za komercijalne svrhe ili se upotrebljavaju za ishranu u toku transporta.</p> <p>2.Manje količine iz stava 1. pod stav 1.2. ovog člana, primenjuju se za: sveže plodove i povrće, osim krompira; sečenih cvetova, buketa cveća; semena u originalnom pakovanju, osim semenskog krompira; rizom dekorativnih biljaka; stabala četinarska bez korena za potrebe praznika i cvetova u saksijama koji se upotrebljavaju ekskluzivno za potrebe krajnjeg korisnika.</p> <p>3. Ministarstvo pod zakonskim aktom utvrđuje male količine bilja prema ovom članu.</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE V</p> <p style="text-align: center;">REGISTAR PROIZVIDEAČA BILJA PAKERA, PRERAĐIVČA, UVOZNIKA, DISTRIBUTERA I MAGACIONERA</p> <p style="text-align: center;">Član 19 Zahtevi za registraciju</p>
---	---	---

<p>1. Personat juridik dhe fizik mund të kryejnë prodhimin, paketimin, përpunimin, importin, deponimi dhe shpërndarja e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera sipas Listave V.A., V.A.1. dhe V.B., në se ata i pëmbushin kërkesat e parapara për këto veprimtari dhe janë të regjistruar zyrtarisht në regjistrin e Ministrisë.</p> <p>2. Regjistrimi është i detyrueshëm për:</p> <p>2.1 prodhues të fidanave, përpunues, paketues shpërndarës, deponues të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera sipas Listave V.A. dhe V.A.I;</p> <p>2.2 importuesit e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera sipas Listës V.B.</p> <p>3 Organi kompetent lëshon licencën që vërteton regjistrimin mbas kryerjes së një verifikimi inspektues nga inspektorët fitosanitarë.</p> <p>4. Ministria me akt nënligjor e përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrave.</p> <p style="text-align: center;">Neni 20 Procedura për regjistrim</p> <p>1. Për t'u regjistruar sipas nenit 19 të këtij Ligji, personat me aftësitë e duhura profesionale për prodhimin dhe mbrojtjen e bimëve duhet të plotësojnë kërkesat e përcaktuara sipas nenit 21 të këtij Ligji.</p>	<p>1. Legal entities and physical persons can perform production, packaging, processing, import, storing or distribution of plants, plant products and other objects included in Lists V.A, V.A.1. and V.B, if they satisfy the requirements foreseen for these activities and they are officially registered in the Ministry's register.</p> <p>2. The registration is obligatory for:</p> <p>2.1 nurserymen, processors, distributors, packagers, storing people of plants, plant products and other objects included in List V.A ad V.A.I;</p> <p>2.2 importers of plants, plant products and other objects included in List V.B.</p> <p>3. The competent organ releases the license attesting the registration after that inspection verification is made by the phytosanitary inspectors.</p> <p>4. The content and the method of register keeping defined by the Ministry in a sub-legal act.</p> <p style="text-align: center;">Article 20 Procedure for registration</p> <p>1. In order to be registered under article 19 of this law, individuals possessing the suitable professional capacity on plant production and protection have to satisfy the requirements specified under article 21 of this Law.</p>	<p>1. Pravna i fizička lica mogu obavijati proizvodnju, pakovanje, preradu, uvoz, deponiranje i distribuciju biljka, biljnih proizvoda i drugih objekata prema listama V.A., V.A.1. i V.B., ukoliko oni ispunjavaju predviđene zahteve za ove delatnosti i zvanično su registrovani u registru Ministarstva.</p> <p>2. Registrovanje je obavezno za:</p> <p>1.1. proizvođače sadnica, prerađivače, paketare, distributere, magazionere biljaka, biljnih proizvoda i drugih objekata iz Liste V.A. i V.A.I;</p> <p>1.2. uvoznike bilja, biljnih proizvoda i drugih objekata iz Liste V.B.</p> <p>3. Nadležni organ izdaje licencu i potvrđuje registraciju nakon izvršenja inspekcijske verifikacije od strane fitosanitarnih inspektora.</p> <p>4. Ministarstvo pod zakonskim aktom utvrđuje sadržinu i način vođenja registra.</p> <p style="text-align: center;">Član 20 Procedura o registraciji</p> <p>1. Radi registracije prema članu 19. ovog zakona, lica sa valjanim stručnim sposobnostima za proizvodnju i zaštitu bilja treba da ispune utvrđene zahteve prema članu 21. ovog Zakona.</p>
---	--	---

2.Për regjistrim sipas nenit 21 të këtij Ligji, duhet t'i dërgohet një kërkesë me shkrim organit kompetent
3.Ministria merr një vendimin për regjistrimin jo më vonë se 30 ditë nga marrja e kërkesës dhe dokumentacionit.

4. Nëse ndonjë subjekt i regjistruar nuk përmbush detyrimet dhe kërkesat sipas këtij ligji, Ministria anulon regjistrimin e tij.

Neni 21
Detyrat e personave të regjistruar

- 1.Personat e regjistruar janë të detyruar të:
- 1.1 mbajnë shënime për prodhimin, paketimin, përpunimin dhe qarkullimin e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera të cilat i kanë në ruajtje apo planifikojnë t'i rimbjellin në pronën e tyre, t'i përpunojnë ose shpërndajnë në një vend tjetër;
 - 1.2 mbajnë dhe plotësojnë rregullisht planin e vendosjes aty ku bimët kultivohen, përpunohen, ruhen dhe përdoren;
 - 1.3 kryejnë në mënyrë të rregullt kontrole vizuale në bimë;
 - 1.4 lejojnë qasjen e inspektoriëve fitosanitarë për të inspektuar dhe kontrolluar bimët, vendosjen e tyre dhe dokumentacionin, si dhe për të marrë mostra;

2. In order to be registered under article 21 of this law, a written request must be submitted to the competent organ.

3.The Ministry takes a decision on the registration not later than 30 days from the reception of the request and documentation.

4. If any registered subject interrupts the satisfaction of the responsibilities and requirements under this Law, the Ministry cancels his registration.

Article 21
Duties of registered subjects

- 1.Registered subjects are obliged to:
- 1.1 keep notes on production, packing, processing and movement of plants, plant products and other objects, which are stored or intended for replanting in their property, processed in or distributed to another location;
 - 1.2 regularly keep and fill in the plan of the location whereby plants are grown, processed, stored or used;
 - 1.3 regularly perform the appropriate visual checks in plants;
 - 1.4 allow the access of the phytosanitary inspectors in order to inspect and check plants, location and documentation as well as to take samples;

2.Za registraciju prema članu 21. ovog Zakona, nadležnom organu treba podneti pismeni zahtev.

3.Ministar donosi odluku o registraciju najkasnije za 30 dana od dobijanja zahteva i dokumentacije.

4.Ako neki registrovan subjekat ne ispunjava obaveze i zahteve prema ovom Zakonu, Ministarstvo poništava njegovo registrovanje.

Član 21
Zadaci registrovanih lica

- 1.Registrovana lica su dužni :
- 1.1. da vode podatke o proizvodnju, pakovanju, prerađu i promet bilja, biljnih proizvoda i druge objekte koje imaju na čuvanju ili planiraju da ponovo sade u njihovim posedima, prerađuju ili distribuiraju na drugom mestu;
 - 1.2. da održavaju i redovno ispune plan smeštaja tamo gde se bilje uzgajaju, prerađuju, čuvaju ili koriste;
 - 1.3. izvrše na redovan način potrebne vizuelne kontrole na biljke;
 - 1.4. da dozvole pristup fitosanitarnih inspektora radi inspekcije i kontrole biljaka,njihovom smeštaju i dokumentacije i radi uzimanja uzoraka.

<p>1.5 lajmërojnë organin kompetent në Ministri ose inspektionin fitosanitar për të gjitha paraqitjet dhe shtimin e numrit të organizmave të dëmshëm në bimë dhe për prodhimtarinë e tyre;</p> <p>1.6 paraqesin organit kompetent të gjitha ndryshimet e të dhënave të cilat mbahen në regjistër në afatin e përcaktuar nga Ministria;</p> <p>1.7 raportojnë brenda afatit të duhur çdo vit organin kompetent dhe Inspektionin fitosanitar për sasinë dhe vendndodhjen e prodhimit dhe përpunimit të bimëve dhe të produkteve bimore;</p> <p>1.8 bashkëpunojnë me organin kompetent dhe me Inspektionin fitosanitar në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e shëndetit të bimëve; dhe</p> <p>1.9 të ruajnë dokumentacionin së paku një vit.</p> <p>2.Ministria me akt nënligjor i përcakton teknikat e kryerjes së kontrollit shëndetësor të bimëve, afatet, përmbajtjen dhe mënyrën e dërgimit të të dhënave të përcaktuara sipas paragrafit 1 nënparagrafit 1.1 të këtij neni.</p> <p style="text-align: center;">Neni 22 Përrjashtime nga regjistrimi</p>	<p>1.5 inform the competent organ in the Ministry or the phytosanitary inspectorate on all occurrences and increases of the number of harmful organisms in plants and on their productivity;</p> <p>1.6 submit all the changes of the data kept in the register to the Competent organ within the term officially designated by the Ministry;</p> <p>1.7 within the appropriate term, report annually to the competent organ and to the Phytosanitary inspectorate on the quantity and location of production and processing of plants and plant products;</p> <p>1.8 cooperate with the competent organ and the phytosanitary inspectorate in order to ensure plant health protection; and</p> <p>1.9 saves the documentation for at least one year.</p> <p>2. The Ministry regulates in a sub-legal act the plant health check technique, terms, content and sending method for the data under paragraph 1, subparagraph 1.1 of this article.</p> <p style="text-align: center;">Article 22 Exceptions in registration</p>	<p>1.5. da obaveste nadležni organ u Ministarstvu ili fitosanitarnog inspektora o svim pojavama i porastu broja štetnih organizama na biljke i o njihovoj proizvodnji;</p> <p>1.6. da nadležnom organu prijave sve izmene podataka koji se vode u registru u roku utvrđenom zvanično od strane Ministarstva;</p> <p>1.7. da u okviru valjanog roka svake godine raportira nadležnom organu i fitosanitarnoj inspekciji o količini i mesto nalaženja proizvodnje i prerade bilja i biljnih proizvoda;</p> <p>1.8. da saraduje sa nadležnim organom i sa fitosanitarnim inspektorom kako bi se obezbedilo zaštita zdravlja biljaka; i</p> <p>1.9. da sačuva dokumentaciju najmanje jednu godinu.</p> <p>2.Ministarstvo pod zakonskim aktom utvrđuje tehlike izvršenja zdravstvene kontrole biljaka, rokove, sadržaj i način upućivanja podataka utvrđenim stavom 1. pod stav 1.1.ovog člana.</p> <p style="text-align: center;">Član 22 Izuzete iz registracije</p>
--	--	---

Përfashtuar nga dispozitat e nenit 21, regjistrimi nuk është i detyrueshëm për prodhuesit dhe përpunuesit e vegjël të cilët nuk kryejnë prodhim dhe përpunim profesional të bimëve, ose kur prodhimi dhe shitja e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera të tyre destinohet për nevoja personale të personave fizik në tregun lokal që nuk rrezikon përhapjen e organizmave të dëmshëm.

KREU VI

IMPORTI, EKSPORTI DHE TRANZITI I DËRGESAVE BIMORE

Neni 23 Importi

1.Importi i bimëve lejohet nëse:

- 1.1 importuesi është i pajisur me licencë importi të lëshuar nga organi kompetent i Ministrisë,
asnjë nga frutat e vjelë në fushën e prodhimit nuk ka shfaqur simptoma të këtij organizmi, në egzaminimin përkatës zyrtar.

16.5. Frutat e *Citrus* L., *Fortunella* Swingle, *Poncirus* Raf., dhe hibridet e tyre, me origjinë nga vendet e treta (jo-anëtare të BE) ku *Tephritidae* (jo-Europiane) dihet të jenë hasur mbi këto fruta

Pa cënuar kushtet e aplikueshme për frutat në Aneksin III(B)(2), (3), dhe Aneksin IV(A)(I)(16.1), (16.2) dhe (16.3), deklarimi zyrtar që:

- (a) frutat janë me origjinë nga zona të njohura që të jenë të pastra nga organizmi përkatës; ose, nëse kjo kërkesë nuk mund të plotësohet
- (b) shenja të organizmit përkatës nuk janë vërejtur në vendin e prodhimit dhe në afërsi imediate me të, që prej fillimit të ciklit të fundit të plotë vegjetativ, bazuar mbi inspektimet zyrtare të kryera së paku cdo muaj gjatë tremujve të fundit para vjeljes, dhe asnjë nga frutat e vjelë në vendin e prodhimit, nuk ka shfaqur shenja të organizmit përkatës, nga egzaminimi përkatës zyrtar, ose nëse kjo kërkesë gjithashtu nuk mund të jetë plotësuar;
- (c) në egzaminimet përkatëse zyrtare mbi mostra përfaqësuese, frutat kanë treguar që të jenë të pastra nga organizmi përkatës në të gjitha fazat e zhvillimit të tyre vegjetativ; ose, nëse kjo kërkesë gjithashtu nuk mund të jetë plotësuar;
- (d) frutat kanë qenë subjekt I trajtimit përkatës, ndonjë trajtimi të pranueshëm me avull të nxehtë, trajtim të ftohtë, ose trajtim të menjëhershëm me ngrirje, të cilat kanë treguar se janë efikase kundra organizmit përkatës pa e dëmtuar frutin, dhe kur ato nuk janë të realizueshme, trajtim kimik aq sa të jetë I pranueshëm

nga legjislacioni I Komunitetit.

17.- Bimët e *Amelanchier* Med., *Chaenomeles* Lindl., *Cotoneaster* Ehrh., *Crataegus* L., *Cydonia* Mill., *Eriobotrya* Lindl., *Malus* Mill., *Mespilus* L., *Photinia davidiana* (Dcne.) Cardot, *Pyracantha* Roem., *Pyrus* L. Dhe *Sorbus* L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat

Pa çënuar kushtet e aplikueshme për bimët e listuara përkatësisht në Aneksin III(A)(9), (9.1), (18), Aneksin III(B)(1) ose Aneksin IV(A)(I)(15), deklarimi zyrtar:

- (a) që bimët janë me origjinë nga vende të pranuar që të jenë të pastra nga *Erwinia amylovora* (Burr.) Winsl. et al. në pajtim me procedurën e vendosur në Artikullin 18(2),
ose
- (b) që bimët janë me origjinë nga zona të pastra nga parazitët, të cilat janë krijuar të tilla në lidhje me *Erwinia amylovora* (Burr.) Winsl. et al. në pajtim me Standardet Ndërkombëtare mbi Masat Fitosanitare përkatëse dhe të pranuar si të tilla në pajtim me procedurën e vendosur në Artikullin 18(2),
ose
- (c) që bimët në fushën e prodhimit dhe në afërsi imediate me të, që kanë shfaqur simptoma të *Erwinia amylovora* (Burr.) Winsl. et al., janë eliminuar.

18. Bimët e *Citrus* L., *Fortunella* Swingle, *Poncirus* Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat e farat dhe bimët e *Araceae*, *Marantaceae*, *Musaceae*, *Persea* spp. dhe *Strelitziaceae*, të rrënjëzuara, ose me terren rritës bashkëngjitur ose shoqëruar

Pa çënuar ndalesat e aplikueshme për bimët e listuara në Aneksin III (A) (16), deklarimi zyrtar që:

- (a) bimët janë me origjinë nga vende të njohura të jenë të pastra nga *Radopholus citrophilus* Huettel et al. dhe *Radopholus similis* (Cobb) Thorne;
ose
- (b) mostra përfaqesuese të tokës dhe rrënjëve nga vendi i prodhimit i janë nënshtruar që nga fillimi i ciklit të fundit të plotë vegjetativ, testimi zyrtar nematologjik të paktën për *Radopholus citrophilus* Huettel et al. dhe *Radopholus similis* (Cobb) Thorne dhe janë gjetur në këto teste të pastra nga këta organizma.

19.1. Bimët e *Crataegus* L. të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vende ku *Phyllosticta solitaria* Ell. and Ev. Dihet se është hasur

Pa çënuar kushtet e aplikueshme për bimët e listuara në Aneksin III (A) (9) dhe (18), dhe Aneksin IV (A) (I) (15) e (17), deklarimi zyrtar që simptoma të *Phyllosticta solitaria* Ell. and Ev. Nuk janë vërejtur mbi bimët në vendin e prodhimit që prej fillimit të ciklit të fundit të plotë vegjetativ.

19.2. Bimët e *Cydonia* Mill., *Fragaria* L., *Malus* Mill., *Prunus* L., *Pyrus* L., *Ribes* L., *Rubus* L. të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vende ku parazitët përkatës dihet që janë hasur mbi bimët e gjinive përkatëse

Pa çënuar kushtet e aplikueshme për bimët e listuara në Aneksin III (A) (9) e (18), dhe Aneksin IV (A) (I) (15) e (17), deklarimi zyrtar që simptoma të sëmundjeve të shkaktuara nga parazitët përkatës, nuk janë vërejtur mbi bimët në vendin e prodhimit që nga fillimi i ciklit të fundit të plotë vegjetativ.

Këta parazitë janë:

- mbi *Fragaria* L.:

Phytophthora fragariae Hickman, var. *fragariae*,

Arabis mosaic virus,

Raspberry ringspot virus,

Strawberry crinkle virus,

Strawberry latent ringspot virus,

Strawberry mild yellow edge virus,

Tomato black ring virus,

Xanthomonas fragariae Kennedy et King;

mbi *Malus* Mill.:

Phyllosticta solitaria Ell. and Ev.;

mbi *Prunus* L.:

Apricot chlorotic leafroll mycoplasma,

Xanthomonas campestris pv. *prunis* (Smith)

Dye,

mbi *Prunus persica* (L.) Batsch:

Pseudomonas syringae pv. *persicae*

(Prunier *et al.*) Young *et al.*;

mbi *Pyrus* L.:

Phyllosticta solitaria Ell. and Ev.;

mbi *Rubus* L.:

Arabis mosaic virus,

Raspberry ringspot virus,

Strawberry latent ringspot virus,

Tomato black ring virus,

mbi të gjitha speciet:

viruset dhe organizmat si-viruset, jo-

Europiane

20. Bimët e *Cydonia* Mill. dhe *Pyrus* L. të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vende ku Pear decline mycoplasma dihet se është hasur

Pa cënuar kushtet e aplikueshme për bimët e listuara në Aneksin III(A)(9) e (18), dhe Aneksin IV(A)(I)(15), (17) e (19.2), deklarimi zyrtar që bimët në vendin e prodhimit dhe në afërsi imediate të tij, të cilat kanë shfaqur simptoma duke krijuar dyshimin për kontaminim nga Pear decline mycoplasma, kanë qenë asgjësuar në atë vend gjatë tre cikleve të fundit të plota vegetative.

21.1. Bimët e *Fragaria* L. të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vende ku parazitët përkatës dihet që janë hasur

Pa cënuar kushtet e aplikueshme për bimët e listuara në Aneksin III(A)(18), dhe Aneksin IV(A)(I)(19.2), deklarimi zyrtar që:

Këta parazitë janë:

Strawberry latent «C» virus,

Strawberry vein banding virus,

Strawberry witches' broom mycoplasma

(a) Bimët, të ndryshme nga ato që janë rritur nga fara, kanë qenë:

gjithashtu të certifikuar zyrtarisht sipas një skeme certifikimi duke kërkuar që ato të kenë rrejedhur në vijë të drejtpërdrejtë nga materiali i ruajtur në kushte të caktuara, dhe që ka qenë subjekt i testimeve zyrtare të paktën për parazitët e përmendur, duke përdorur indikatorët përkatës ose metoda ekuivalente dhe në këto testime, janë gjetur të pastra, nga këta parazitë, ose

të rrjedhura në vijë të drejtëdrejtë nga materiali i ruajtur në kushte të caktuara dhe që ka qenë subjekt i testimi zyrtar për të paktën një herë brenda 3 cikleve të plota vegetative, të paktën për parazitët e përmendur, duke përdorur indikatorët përkatës, ose metoda ekuivalente dhe që në këto testime janë gjetur të pastra nga këta parazitë,

(b) simptoma të sëmundjeve, të shkaktuara nga parazitët e përmendur nuk kanë qenë vërejtur në bimë në vendin e prodhimit, ose mbi bimë të ndjeshme në afërsi imediate me të, qysh prej fillimit të ciklit të

fundit të plotë vegetativ.

21.2. Bimët e *Fragaria* L. të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vendet ku *Aphelenchoides besseyi* Christie dihet se është hasur

Pa çenuar kushtet e aplikueshme për bimët e listuara në Aneksin III(A)(18), dhe Aneksin IV(A)(I)(19.2) dhe (21.1), deklarimi zyrtar që:

(a) gjithashtu, simptoma të *Aphelenchoides besseyi* Christie nuk janë vërejtur mbi bimë në vendin e prodhimit që prej fillimit të ciklit të fundit të plotë vegetativ,

ose

(b) në rastin e bimëve *in vitro*, bimët kanë rrjedhur nga bimë që plotësojnë kërkesat e seksionit (a) të kësaj pike, ose kanë qënë testuar zyrtarisht nga metoda të caktuara nematologjike dhe janë gjetur të pastra nga *Aphelenchoides besseyi* Christie.

21.3. Bimët e *Fragaria* L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat

Pa çenuar kushtet e aplikueshme për bimët e listuara në Aneksin III(A)(18), dhe Aneksin IV(A)(I)(19.2) dhe (21.1) e (21.2), deklarimi zyrtar që bimët janë me origjinë nga një zonë e njohur që të jetë e pastër nga *Anthonomus signatus* Say and *Anthonomus bisignifer* (Schenkling).

22.1. Bimët e *Malus* Mill. të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vende ku parazitët përkatës që përmenden, njihen të jenë hasur mbi *Malus* Mill. parazitët përkatës janë:

Cherry rasp leaf virus (Amerikan),

Tomato ringspot virus

Pa çenuar kushtet e aplikueshme për bimët e listuara në Aneksin III(A)(9) e (18), Aneksin III(B)(1) dhe Aneksin IV(A)(I)(15), (17) dhe (19.2), deklarimi zyrtar që:

(a) bimët kanë qenë:

gjithashtu të certifikuar zyrtarisht sipas një skeme certifikimi duke kërkuar që ato të kenë rrejedhur në vijë të drejtpërdrejtë nga materiali i ruajtur në kushte të caktuara, dhe që ka qënë subjekt i testimeve zyrtare të paktën për parazitët e përmendur, duke përdorur indikatorët përkatës ose metoda ekuivalente dhe në këto testime, janë gjetur të pastra, nga këta parazitë,

ose

të rrjedhura në vijë të drejtëerdrejtë nga materiali i ruajtur në kushte të caktuara dhe që ka qënë subjekt i testimit zyrtar për të paktën një herë brenda 3 cikleve të plota vegetative, të paktën për parazitët e përmendur, duke përdorur indikatorët përkatës, ose metoda ekuivalente dhe që në këto testime janë gjetur të pastra nga këta parasite;

(b) simptoma të sëmundjeve të shkaktuara nga parazitët e përmendur nuk janë vërejtur mbi bimët në vendin e prodhimit, ose mbi bimë të ndryshme në afërsi imediate me të që prej fillimit të ciklit të fundit të plotë vegetativ.

22.2. Bimët e *Malus* Mill. të planifikuara për mbjellje, me origjinë nga vendet ku dihet se është hasur apple proliferation mycoplasma

Pa çenuar kushtet e aplikueshme për bimët e listuara në Aneksin III (A) (9) e (18), Aneksin III (B) (I) dhe Aneksin IV (A) (I) (15), (17),(19.2) dhe (22.1), deklarimi zyrtar që:

(a) bimët janë me origjinë nga zona që njihen të jenë të pastra nga apple proliferation mycoplasma;

or

(b) (aa) bimët, të ndryshme nga ato të rritura nga farat kanë qenë:

23.1. Bimët e specieve *Prunus* L. që vijojnë, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vendet ku Plum pox virus dihet se është hasur:

Prunus amygdalus Batsch,
Prunus armeniaca L.,
Prunus blireiana Andre,
Prunus brigantina Vill.,
Prunus cerasifera Ehrh.,
Prunus cistena Hansen,
Prunus curdica Fenzl and Fritsch.,
Prunus domestica ssp. *domestica* L.,
Prunus domestica ssp. *insititia* (L.) C.K. Schneid.,
Prunus domestica ssp. *italica* (Borkh.) Hegi.,
Prunus glandulosa Thunb.,
Prunus holosericea Batal.,
Prunus hortulana Bailey,
Prunus japonica Thunb.,
Prunus mandshurica (Maxim.) Koehne,
Prunus maritima Marsh.,
Prunus mume Sieb and Zucc.,
Prunus nigra Ait.,
Prunus persica (L.) Batsch,
Prunus salicina L.,
Prunus sibirica L.,
Prunus simonii Carr.,
Prunus spinosa L.,

gjithashtu të certifikuara zyrtarisht sipas një skeme certifikimi duke kërkuar që ato të kenë rrejedhur në vijë të drejtpërdrejtë nga materiali i ruajtur në kushte të caktuara, dhe që ka qënë subjekt i testimeve zyrtare të paktën për Apple proliferation mycoplasm, duke përdorur indikatorët përkatës ose metoda ekuivalente dhe në këto testime, janë gjetur të pastra, nga ai parazit,

ose

të rrjedhura në vijë të drejtëdrejtë nga materiali I ruajtur në kushte të caktuara dhe që ka qënë subjekt I testimit zyrtar për të paktën një herë brenda 6 cikleve të plota vegetative, të paktën për Apple proliferation mycoplasm, duke përdorur indikatorët përkatës, ose metoda ekuivalente dhe që në këto testime janë gjetur të pastra nga ai parazit;

(bb) simptoma të sëmundjes shkaktuar nga Apple proliferation mycoplasm nuk janë verejtur mbi bimët në vendin e prodhimit, ose në bimë të ndjeshme në afërsi immediate me të, që prej fillimit të tre cikleve të fundit të plota vegetative.

Pa cënuar kushtet e aplikueshme për bimët e listuara në Aneksin III(A)(9) e (18) dhe Aneksin IV(A)(I)(15) e (19.2), deklarimi zyrtar që:

(a) bimët, të ndryshme nga ato që janë rritur nga fara, kanë qënë:

gjithashtu të certifikuara zyrtarisht sipas një skeme certifikimi duke kërkuar që ato të kenë rrejedhur në vijë të drejtpërdrejtë nga materiali i ruajtur në kushte të caktuara, dhe që ka qënë subjekt i testimeve zyrtare të paktën për Plum pox virus, duke përdorur indikatorët përkatës ose metoda ekuivalente dhe në këto testime, janë gjetur të pastra, nga ai parazit,

ose

të rrjedhura në vijë të drejtëdrejtë nga materiali I ruajtur në kushte të caktuara dhe që ka qënë subjekt I testimit zyrtar për të paktën një herë brenda 3 cikleve të plota vegetative, të paktën për Plum pox virus, duke përdorur indikatorët përkatës, ose metoda ekuivalente dhe që në këto testime janë gjetur të pastra nga ai parazit;

(b) simptoma të sëmundjes shkaktuar nga Plum pox virus, nuk janë verejtur mbi bimët në vendin e prodhimit, ose në bimë të ndjeshme në afërsi immediate me të, që prej fillimit të tre cikleve të fundit të plota vegetative;

(c) bimët në vendin e prodhimit që kanë shfaqur simptoma të sëmundjeve të shkaktuara nga viruse të tjera ose patogjenë-si viruse, janë asgjësuar.

Prunus tomentosa Thunb.,

Prunus triloba Lindl.,

Specie të tjera *Prunus* L. të ndjeshme ndaj Plux
pox virus.

23.2. Bimët e *Prunus* L., të planifikuara për mbjellje
(a) me origjinë nga vendet ku parazitët e mëposhtëm
dihen se janë hasur mbi *Prunus* L.

(a) me origjinë nga vendet ku parazitët e
mëposhtëm dihen se janë hasur mbi *Prunus*
L

(b) të ndryshme nga farat, me origjinë nga
vendet ku parazitët përkatës të mëposhtëm
dihet se janë hasur

(c) të ndryshme nga farat, me origjinë nga
vendet jo-Europiane ku parazitët përkatës të
mëposhtëm dihet se janë hasur

Parazitët përkatës janë:

për rastin në pikën (a):

Tomato ringspot virus;

Për rastin në pikën (b):

Cherry rasp leaf virus (Amerikan),

Peach mosaic virus (Amerikan),

Peach phony rickettsia,

Peach rosette mycoplasma,

Peach yellows mycoplasma,

Plum line pattern virus (Amerikan),

Peach X-disease mycoplasma;

Për rastin në pikën (c):

- Little cherry pathogen.

24. Bimët e *Rubus* L., të planifikuara për mbjellje:

(a) me origjinë nga vende ku parazitët dihen që
janë hasur mbi *Rubus* L.

(b) të ndryshëm nga farat, me origjinë nga
vende ku parazitët përkatës të mëposhtëm
dihen se janë hasur

Parazitët përkatës janë:

në rastin (a):

Tomato ringspot virus,

Black raspberry latent virus,

Cherry leafroll virus,

Prunus necrotic ringspot virus,

në rastin (b):

Raspberry leaf curl virus (Amerikan)

Cherry rasp leaf virus (Amerikan)

Pa cënuar kushtet e aplikueshme për bimët e listuara,
përkatësisht në Aneksin III(A)(9) e (18) ose Aneksin
IV(A)(I)(15), (19.2) dhe (23.1), deklarimi zyrtar që:

(a) bimët kanë qenë:

gjithashtu të certifikuar zyrtarisht sipas një skeme
certifikimi duke kërkuar që ato të kenë rrejdhur
në vijë të drejtpërdrejtë nga materiali i ruajtur në
kushte të caktuara, dhe që ka qënë subjekt i
testimeve zyrtare të paktën për parazitët përkatës
të përmendur, duke përdorur indikatorët përkatës
ose metoda ekuivalente dhe në këto testime, janë
gjetur të pastra, nga këta parazitë,
ose

të rrjedhura në vijë të drejtëerdrejtë nga materiali I
ruajtur në kushte të caktuara dhe që ka qënë
subjekt i testimit zyrtar për të paktën një herë
brenda 3 cikleve të plota vegetative, të paktën
për parazitët përkatës të përmendur, duke
përdorur indikatorët përkatës, ose metoda
ekuivalente dhe që në këto testime janë gjetur të
pastra nga këta parazitë;

(b) simptoma të sëmundjeve të shkaktuara nga parazitët
përkatës të përmendur, nuk janë verejtur mbi bimët në
vendin e prodhimit, ose mbi bimë të ndjeshme në
afërsi imediate me të, që prej fillimit të tre cikleve të
fundit të plota vegetative.

Pa cënuar kushtet e aplikueshme për bimët e listuara në
Aneksin IV(A)(I)(19.2),

(a) bimët duhet të janë të pastra nga afidet, përfshirë edhe
vezët e tyre

(b) deklarimi zyrtar që:

(aa) bimët kanë qenë:

gjithashtu të certifikuar zyrtarisht sipas një skeme
certifikimi duke kërkuar që ato të kenë rrejdhur
në vijë të drejtpërdrejtë nga materiali i ruajtur në
kushte të caktuara, dhe që ka qënë subjekt i
testimeve zyrtare të paktën për parazitët përkatës
të përmendur, duke përdorur indikatorët përkatës
ose metoda ekuivalente dhe në këto testime, janë
gjetur të pastra, nga këta parazitë,
ose

të rrjedhura në vijë të drejtëerdrejtë nga materiali I
ruajtur në kushte të caktuara dhe që ka qënë
subjekt i testimit zyrtar për të paktën një herë
brenda 3 cikleve të plota vegetative, të paktën
për parazitët përkatës të përmendur, duke
përdorur indikatorët përkatës, ose metoda
ekuivalente dhe që në këto testime janë gjetur të
pastra nga këta parazitë;

- (bb) simptoma të sëmundjeve të shkaktuara nga parazitët përkatës të përmendur, nuk janë vërejtur mbi bimët në vendin e prodhimit, ose mbi bimë të ndjeshme në afërsi imediate me të, që prej fillimit të cikleve të fundit të plota vegetative.
- 25.1. Tuberët e *Solanum tuberosum* L., me origjinë nga vende ku *Synchytrium endobioticum* (Schilbersky) Percival dihet se është hasur
- Pa cënuar ndalesat e aplikueshme për tuberat e listuar në Aneksin III(A)(10), (11) dhe (12), deklarimi zyrtar që:
- (a) tuberat janë me origjinë nga zona të njohura që të jenë të pastra nga *Synchytrium endobioticum* (Schilbersky) Percival (të gjitha racat të ndryshme nga Race 1, raca e zakonshme Europiane), dhe simptoma të *Synchytrium endobioticum* (Schilbersky) Percival nuk janë vërejtur në vendin e prodhimit ose në afërsi imediate me të që prej fillimit të një periudhe të mjaftueshme;
- ose
- (b) masat për luftimin e *Synchytrium endobioticum* (Schilbersky) Percival në vendin e origjinës kanë qenë përputhur me masat e pranuar si ekuivalente në BE, në pajtim me procedurën e përcaktuar në Artikullin 18(2)
- 25.2. Tuberët e *Solanum tuberosum* L.
- Pa cënuar kushtet e listuara në Aneksin (A)(10), (11) e (12) dhe Aneksin IV(A)(I)(25.1), deklarimi zyrtar që:
- (a) tuberat janë me origjinë nga vende të njohura të jenë të pastra nga *Clavibacter michiganensis* ssp. *sepedonicus* (Spieckermann and Kotthoff) Davis *et al.*;
- ose
- (b) masat për luftimin e *Clavibacter michiganensis* ssp. *sepedonicus* (Spieckermann and Kotthoff) Davis *et al.* në vendin e origjinës kanë qenë përputhur me masat e pranuar si ekuivalente në BE, në pajtim me procedurën e përcaktuar në Artikullin 18(2)
- 25.3. Tuberët e *Solanum tuberosum* L., të ndryshëm nga patatet e hershme, me origjinë nga vende ku Potato spindle tuber viroid dihet se është hasur
- 25.4 Tubere të *Solanum tuberosum* L. të planifikuara për mbjellje
- Pa cënuar kushtet e aplikueshme për tuberët të listuara në Aneksin III(A)(10), (11) e (12) dhe Aneksin IV(A)(I)(25.1) dhe (25.2), ndalimin e aftësisë për mbirje.
- Pa cënuar kushtet e aplikueshme për tuberët e listuar në Aneksin III(A)(10), (11) e (12) dhe Aneksin IV(A)(I)(25.1), (25.2) dhe (25.3), deklarimi zyrtar që tuberët janë me origjinë nga fusha të njohura që të jenë të pastra nga *Globodera rostochiensis* (Wollenweber) Behrens dhe *Globodera pallida* (Stone) Behrens
- dhe
- (aa) gjithashtu, tuberët të jenë me origjinë nga zona ku *Pseudomanas solanacearum* (Smith) Smith dihet që nuk është hasur;
- ose
- (bb) në zonat ku *Pseudomanas solanacearum* (Smith) Smith dihet që është hasur, tuberët janë me origjinë nga një vend prodhimi I gjetur I pastër nga *Pseudomanas solanacearum* (Smith) Smith, ose I konsideruar të jetë I pastër, si pasojë e implementimit të një procedure përkatëse me qëllim c'rrënjësor të *Pseudomanas solanacearum* (Smith) Smith që duhet të jetë përcaktuar në pajtim me procedurën e vendosur

në Artikullin 18(2)

dhe

- (cc) gjithashtu tuberët janë me origjinë nga zona ku *Meloidogyne chitwoodi* Golden *et al.* (gjithë populacionet) dhe *Meloidogyne fallax* Karssen dihet që nuk janë hasur, ose;
- (dd) në zonat ku *Meloidogyne chitwoodi* Golden *et al.* (gjithë populacionet) dhe *Meloidogyne fallax* Karssen dihet që janë hasur,

gjithashtu tuberët janë me origjinë nga një vend prodhimi I cili është gjetur I pastër nga *Meloidogyne chitwoodi* Golden *et al.* (gjithë populacionet), dhe *Meloidogyne fallax* Karssen bazuar mbi vërtetime vjetore të bimëve strehuese me anë të inspektimeve vizuale të bimëve bujtëse në kohë të caktuara dhe me anë të inspektimeve vizuale të tuberëve nga jashtë dhe nga brenda duke i prerë tuberët pas vjeljes së bimëve të patates të rritur në vendin e prodhimit, ose;

pas vjeljes janë marë mostra tuberësh me rastësi dhe, janë kontrolluar për praninë e simptomave sipas një metode të caktuar, ose janë testuar në laborator, po ashtu janë inspektuar edhe vizualisht nga jashtë dhe duke i prerë tuberët, në kohë të caktuara, dhe në të gjitha rastet në kohën e mbylljes së paketimit ose konteinerëve përpara tregëtimit, në pajtim me Direktivën e Keshillit të BE, 66/403/CEE e 14 Qershorit 1996 mbi tregëtimin e patates së farës dhe nga ka rezultuar që simptoma të *Meloidogyne chitwoodi* Golden *et al.* (gjithë populacionet) dhe *Meloidogyne fallax* Karssen nuk janë gjetur

25.5. Bimët e *Solanaceae*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vende ku Potato stolbur mycoplasma dihet se është hasur

Pa cënuar kushtet e aplikueshme për tuberët, të listuara në Aneksin III(A)(10), (11), (12) e (13), dhe Aneksin IV(A)(I)(25.1), (25.2), (25.3) dhe (25.4), deklarimi zyrtar që simptoma të Potato stolbur mycoplasma nuk janë vërejtur mbi bimët në vendin e prodhimit, që prej fillimit të ciklit të fundit, të plotë vegjetativ.

25.6. Bimët e *Solanaceae*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga tuberët e *Solanum tuberosum* L. dhe të ndryshëm nga farat e *Lycopersicon lycopersicum* (L.) Karsten ex Farw., me origjinë nga vende ku Potato spindle tuber viroid dihet se është hasur

Pa cënuar kushtet e aplikueshme për bimët, të listuara përkatësisht në Aneksin III(A)(11), (13), dhe Aneksin IV(A)(I)(25.5), deklarimi zyrtar që simptoma të Potato spindle tuber viroid nuk janë vërejtur mbi bimët në vendin e prodhimit, që prej fillimit të ciklit të fundit, të plotë vegjetativ.

25.7. Bimët e *Capsicum annuum* L., *Lycopersicon lycopersicum* (L.) Karsten ex Farw., *Musa* L., *Nicotiana* L. dhe *Solanum melongena* L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vende ku *Pseudomonas solanacearum* (Smith) Smith dihet se është hasur

Pa cënuar kushtet e aplikueshme për bimët, të listuara përkatësisht në Aneksin III(A)(11) e (13), dhe Aneksin IV(A)(I)(25.5) e (25.6), deklarimi zyrtar që:

- (a) bimët janë me origjinë nga zona të cilat janë gjetur të pastra nga *Pseudomonas solanacearum* (Smith) Smith; ose
- (b) simptoma të *Pseudomonas solanacearum* (Smith) Smith nuk janë vërejtur mbi bimët në vendin e prodhimit, që prej fillimit të ciklit të fundit të plotë vegjetativ

25.8. Tuberët e *Solanum tuberosum* L., të ndryshëm nga ata të planifikuar për mbjellje

Pa cënuar kushtet e aplikueshme për tuberët, të listuar në Aneksin III(A)(12) dhe Aneksin IV(A)(I)(25.1), (25.2) e (25.3), deklarimi zyrtar që tuberët janë me origjinë nga

- zona në të cilat *Pseudomonas solanacearum* (Smith) Smith nuk dihet të jetë hasur.
26. Bimët e *Humulus lupulus* L. të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat Deklarimi zyrtar që simptoma të *Verticillium albo-atrum* Reinke and Berthold dhe *Verticillium dahliae* Klebahn nuk janë vërejtur mbi lupulus në vendin e prodhimit, që prej fillimit të ciklit të fundit, të plotë vegetativ.
- 27.1. Bimët e *Dendranthema* (DC.) Des Moul., *Dianthus* L. dhe *Pelargonium* l'Hérit. ex Ait., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat Deklarimi zyrtar që:
- (a) shenja të *Heliothis armigera* Hübner, ose *Spodoptera littoralis* (Boisd.) nuk janë vërejtur mbi lupulus në vendin e prodhimit, që prej fillimit të ciklit të fundit, të plotë vegetativ,
- ose
- (b) bimët I janë nështruar trajtimeve përkatëse për mbrojtjen e tyre nga parazitët e përmendur.
- 27.2. Bimët e *Dendranthema* (DC.) Des Moul., *Dianthus* L. dhe *Pelargonium* l'Hérit. ex Ait., të ndryshme nga farat Pa cënuar kërkesat e aplikueshme për bimët, të listuara në Aneksin IV(A)(I)(27.1),
- (a) shenja të *Spodoptera eridiana* Cramer, *Spodoptera frugiperda* Smith, ose *Spodoptera litura* (Fabricius) nuk janë vërejtur në vendin e prodhimit, që prej fillimit të ciklit të fundit, të plotë vegetativ,
- ose
- (b) bimët i janë nështruar trajtimeve përkatëse për mbrojtjen e tyre nga parazitët e përmendur.
28. Bimët e *Dendranthema* (DC.) Des Moul., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat Pa cënuar kërkesat e aplikueshme për bimët, të listuara në Aneksin IV(A)(I)(27.1) dhe (27.2), deklarimi zyrtar që:
- (a) bimët janë fond jo më shumë se të gjeneracionit të trtë, kanë rrjedhur nga materiali që është gjetur I pastër nga *Chrysanthemum stunt viroid* gjatë testeve virologjike, ose janë të rrjedhura direkt nga materiali prej të cilit një mostër përfaqësuese prej të paktë 10% ka qenë gjetur e pastër nga *Chrysanthemum stunt viroid* gjatë inspektimi zyrtar të kryer në kohën e lulëzimit;
- (b) bimët ose copat:
- kanë ardhur nga vende të cilat janë inspektuar zyrtarisht të paktën cdo muaj, gjatë tre muajve para shpërndarjes dhe mbi të cilat asnjë simptomë e *Puccinia horiana* Hennings nuk është vërejtur gjatë asaj periudhe, dhe në afërsi imediate të të cilave asnjë simptomë e *Puccinia horiana* Hennings nuk është ditur të jetë hasur gjatë tre muajve para eksportit.
- ose
- I janë nështruar trajtimeve përkatëse kundra *Puccinia horiana* Hennings;
- (c) në rastin e copave të pa rrënjëzuara, asnjë simptomë e *Didymella ligulicola* (Baker, Dimock and Davis) v. Arx nuk ishte vërejtur si mbi copat, ashtu dhe mbi bimët prej të cilave kishin rrjedhur copat, ose që, në rastin e copave të rrënjëzuara, asnjë simptomë e *Didymella ligulicola* (Baker, Dimock and Davis) v. Arx ishte vërejtur si mbi copat, ashtu dhe mbi shtratin e rrënjëzimit.
29. Bimët e *Dianthus* L., të planifikuara për mbjellje, të Pa cënuar kërkesat e aplikueshme për bimët, të listuara në

ndryshme nga farat

30. Bulbat e *Tulipa L.* dhe *Narcissus L.*, të ndryshëm nga ata për të cilët evidentohet nga paketimi I tyre, ose nga mënyra të tjera, që ata janë planifikuar të shiten tek konsumatori I fundit jo I përfshire në prodhimin profesional të luleve të prera

31. bimët e *Pelargonium L'Herit. ex Ait.*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vende ku Tomato ringspot virus dihet se është hasur:

(a) ku *Xiphinema americanum Cobb sensu lato* (populacionet jo-Europiane) ose vectorë të tjerë të Tomato ringspot virus nuk dihen të jenë hasur

(b) ku *Xiphinema americanum Cobb sensu lato* (populacionet jo-Europiane) ose vectorë të tjerë të Tomato ringspot virus dihen se janë hasur

32.1. Bimë të specieve barishtore, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga:

bullbat,

drithi,

bimë të familjes Graminaceae

rhizomat,

farërat,

tuberët,

me origjinë nga vendet e treat (jo-anëtare të BE) ku *Liriomyza sativae* (Blanchard) dhe *Amauromyza maculosa* (Malloch) dihen se janë hasur

Aneksin IV(A)(I)(27.1) dhe (27.2), deklarimi zyrtar që:

Bimët kanë rrjedhur në vijë të drejtë nga bimë mëmë të cilat janë gjetur të pastra nga *Erwinia chrysanthemi* pv. *dianthicola* (Hellmers) Dickey, *Pseudomonas caryophylli* (Burkholder) Starr and Burkholder dhe *Phialophora cinerescens* (Wollenw.) Van Beyma nga testimet zyrtare të miratuara, të kryera të paktën një herë brenda dy viteve të mëparëshme,

asnjë symptomë e parazitëve të mësiperm nuk është vërejtur mbi bimët.

Deklarimi zyrtar që asnjë symptomë e *Ditylenchus dipsaci* (Kuhn) Filipjev nuk është vërejtur në bimë që prej fillimit të ciklit të fundit të plotë vegjetativ.

Pa çenuar kërkesat e aplikueshme për bimët, të listuara në Aneksin IV(A)(I)(27.1) dhe (27.2),

Deklarimi zyrtar që bimët:

(a) kanë rrjedhur direct nga vendet e prodhimit të njohura që janë të pastra nga Tomato ringspot virus;

ose

(b) janë të një fondi jo më shumë se gjeneracioni I katërt, të rrjedhura nga bimë mëmë të gjetura të pastra nga Tomato ringspot virus sipas një sistemi zyrtar të aprovuar të testimit virologjik.

Deklarimi zyrtar që bimët:

(a) kanë rrjedhur direct nga vendet e prodhimit të njohura që janë të pastra nga Tomato ringspot virus në tokë ose bimë;

ose

(b) janë të një fondi jo më shumë se gjeneracioni I dytë, të rrjedhura nga bimë mëmë të gjetura të pastra nga Tomato ringspot virus sipas një sistemi zyrtar të aprovuar të testimit virologjik.

Pa çenuar kërkesat e aplikueshme për bimët, të listuara përkatësisht në Aneksin IV, Pjesa A, Seksioni I(27.1), (27.2), (28) dhe (29), deklarimi zyrtar që bimët kanë qënë rritur në fidanishte dhe:

(a) janë me origjinë nga një zonë në vendin eksportues, e përcaktuar nga shërbimi nacional I mbrojtjes së bimëve në atë vend, si e patër nga *Liriomyza sativae* (Blanchard) dhe *Amauromyza maculosa* (Malloch) në pajtim me Standardet Ndërkombëtare përkatëse për Masat Fitosanitare dhe kjo është përmendur në certifikatat e referuara në Artikujt 7 dhe 8 të kësaj Direktive, në rubricën “Deklarim shtesë”,

ose

(b) janë me origjinë nga një zonë në vendin eksportues, e përcaktuar nga shërbimi nacional I mbrojtjes së bimëve në atë vend, si e patër nga *Liriomyza sativae* (Blanchard) dhe *Amauromyza maculosa* (Malloch) në pajtim me Standardet Ndërkombëtare përkatëse për

Masat Fitosanitare dhe kjo është përmendur në certifikatat e referuara në Artikujt 7 dhe 8 të kësaj Direktive, në rubricën “Deklarim shtesë” dhe janë deklaruar të pastra nga *Liriomyza sativae* (Blanchard) dhe *Amauromyza maculosa* (Malloch) mbi bazën e inspektimeve zyrtare të kryera të paktën cdo muaj gjatë tre muajve të fundit para eksportimit,

ose

- (c) menjëherë para eksportimit kanë qenë subject I një trajtimi përkatës kundra *Liriomyza sativae* (Blanchard) dhe *Amauromyza maculosa* (Malloch) dhe kanë qenë inspektuar zyrtarisht e janë gjetur të pastra nga *Liriomyza sativae* (Blanchard) dhe *Amauromyza maculosa* (Malloch). Detje mbi trajtimin duhet të jenë përmendur në certifikatat e referuara në Artikujt 7 dhe 8 të kësaj Direktive.

32.2. Lulet e prera të *Dendranthema* (DC) Des. Moul., *Dianthus* L., *Gypsophila* L. dhe *Solidago* L., dhe perimet gjethore të *Apium graveolens* L. dhe *Ocimum* L.

Deklarimi zyrtar që lulet e prera dhe perimet gjethore:

janë me origjinë nga një vend I pastër nga *Liriomyza sativae* (Blanchard) dhe *Amauromyza maculosa* (Malloch),

ose

menjëherë para eksportimit të tyre janë inspektuar zyrtarisht dhe janë gjetur të pastra nga *Liriomyza sativae* (Blanchard) and *Amauromyza maculosa* (Malloch)

32.3. Bimë të specieve barishtore, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga:

bullbat,

drithi,

bimë të familjes Graminaceae

rhizomat,

farërat,

tuberët,

me origjinë nga vendet e treat (jo-anëtare të BE)

Pa cënuar kërkesat e aplikueshme për bimët, të listuara në Aneksin IV, Pjesa A, Seksioni I(27.1), (27.2), (28), (29) dhe (32.1), deklarimi zyrtar që:

- (a) bimët janë me origjinë nga një zonë e njohur që të jetë e pastër nga *Liriomyza huidobrensis* (Blanchard) and *Liriomyza trifolii* (Burgess),

ose

- (b) gjithashtu asnjë shenjë e *Liriomyza huidobrensis* (Blanchard) dhe *Liriomyza trifolii* (Burgess) nuk është vërejtur në vendin e prodhimit, bazuar mbi inspektimet zyrtare të kryera të paktën cdo muaj gjatë tre muajve të fundit para vjeljes,

ose

- (c) menjëherë para eksportimit, bimët janë inspektuar zyrtarisht dhe janë gjetur të pastra nga *Liriomyza huidobrensis* (Blanchard) dhe *Liriomyza trifolii* (Burgess) dhe kanë qenë subject I trajtimit të përkatës kundra *Liriomyza huidobrensis* (Blanchard) dhe *Liriomyza trifolii* (Burgess)

33. Bimë me rrënjë, të mbjella ose të planifikuara për mbjellje, të rritura në fushë të hapur

Deklarimi zyrtar që vendi I prodhimit është njohur të jetë I pastër nga *Clavibacter michiganensis* ssp. *sependoniscus* (Spieckermann and Kotthoff) Davis et al., *Globodera pallida* (Stone) Behrens, *Globodera rostochiensis* (Wollenweber) Behrens dhe *Synchytrium endobioticum* (Schilbersky) Percival.

Deklarimi zyrtar që:

- (a) terreni rritës, në kohën e mbjelljes, ishte: i pastër nga toka dhe lënde organike

34. Tokë ose terren rritës bashkëngjitur ose të shoqëruar me bimët, të përbërë tërësisht ose pjesërisht prej toke ose substancave organike të ngurta të tilla si pjesë bimësh, humus, përfshirë torfën ose lëkurë ose cdo substancë inorganike të ngurtë, që shërben për të

mbështetur vitalitetin e bimëve, me origjinë nga:

Turqia,
Bjellorusia, Gjeorgjia, Moldavia, Rusia, Ukraina,
Vendet jo-Europiane të ndryshme nga Algjeria,
Egypti, Izraeli, Libia, Moroku, Tunizia

ose

gjetur I pastër nga insektet dhe nematodat parazitare dhe subjekt I egzaminimit përkatës ose trajtimit me nxehtësi, ose fumigimit, për të garantuar pastërtinë nga parazitët,

ose

subjekt i trajtimit të përshtatshëm me nxehtësi ose fumigimit për të garantuar pastërtinë nga parazitët, dhe

(b) që nga mbjellja:

janë marrë masat e nevojshme për të siguruar që terreni rritës është mbajtur i pastër nga parazitët, ose

brenda dy javësh para shpërndarjes, bimët ishin shkundur për të qenë të pastra nga terreni duke lënë sasi minimale të nevojshme për të ruajtur vitalitetin gjatë transportit, dhe terreni ushqyes I përdorur për atë qëllim plotëson kërkesat e përkrahura në (a).

35.1. Bimët e *Beta vulgaris* L. të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat.

Deklarimi zyrtar që asnjë symptomë e Beet curly top virus (izolate jo-Europiane) nuk është vërejtur në vendin e prodhimit që nga fillimi i ciklit të fundit të plotë vegjetativ.

35.2. Bimët e *Beta vulgaris* L të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vende ku Beet leaf curly top virus dihet se është hasur

Pa çenuar kërkesat e aplikueshme për bimët, të listuara në Aneksin IV(A)(I)(35.1), deklarimi zyrtar që:

(a) Beet leaf curl virus nuk është njohur të jetë hasur në zonën e prodhimit, dhe

(b) asnjë symptomë e Beet leaf curl virus nuk është vërejtur në vendin e prodhimit, ose në afërsi imediate me të, që prej fillimit të ciklit të fundit, të plotë vegjetativ.

36.1. Bimët, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga:

bullbat,
drithi,
rhizomat,
farërat,
tuberët,

me origjinë nga vendet e treat (jo-anëtare të BE)

Pa çenuar kërkesat e aplikueshme për bimët në Aneksin IV, Pjesa A, Seksioni I(27.1), (27.2), (28), (29), (31), (32.1) dhe (32.3), deklarimi zyrtar që bimët janë rritur në fidanishte dhe:

(a) janë me origjinë nga një zonë, e përcaktuar nga shërbimi nacional I mbrojtjes së bimëve në vendin eksportues, që është e pastër nga *Thrips palmi* Karny në pajtim me Standardet Ndërkombëtare përkatëse për Masat Fitosanitare, dhe kjo është përmendur në certifikatat e referuara në Artikujt 7 ose 8 të kësaj Direktive, në rubricën “Deklarime shtesë”, ose

(b) janë me origjinë nga një vend prodhimi, i përcaktuar nga shërbimi nacional I mbrojtjes së bimëve në vendin eksportues, që është i pastër nga *Thrips palmi* Karny në pajtim me Standardet Ndërkombëtare përkatëse për Masat Fitosanitare, dhe kjo është përmendur në certifikatat e referuara në Artikujt 7 ose 8 të kësaj Direktive, në rubricën “Deklarime shtesë”, dhe janë deklaruar të pastra nga *Thrips palmi* Karny nga inspektimet zyrtare të kryera së paku cdo muaj gjatë tre muajve të fundit para eksportimit, ose

- (c) menjëherë para eksportimit, kanë qenë subject I një trajtimi përkatës kundra *Thrips palmi* Karny dhe janë inspektuar zyrtarisht e janë gjetur të pastra nga *Thrips palmi* Karny. Detaje mbi trajtimin duhet të jenë përmendur në certifikatat e referuara në Artikujt 7 ose 8 të kësaj Direktive.

36.2. Lulet e prera të Orchidaceae dhe fruta të *Momordica* L. dhe *Solanum melongena* L., me origjinë nga vendet e treta (jo-anëtare të BE)

Deklarimi zyrtar që lulet e prera dhe frutat:

janë me origjinë nga një vend I pastër nga *Thrips palmi* Karny,

ose

menjëherë para eksportimit janë inspektuar zyrtarisht dhe janë gjetur të pastra nga *Thrips palmi* Karny

37. Bimët e Palmae të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vendet jo-Europiane

Pa cënuar ndalesat e aplikueshme për bimët e listuara përkatësisht në Aneksin III(A)(17), deklarimi zyrtar që:

- (a) bimët janë me origjinë nga një zonë e njohur të jetë e pastër nga Palm lethal yellowing mycoplasma dhe Cadang-Cadang viroid, asnjë symptomë e tyre nuk është vërejtur në vendin e prodhimit ose në afërsi imediate me të që prej fillimit të ciklit të fundit të plotë vegjetativ;

ose

- (b) asnjë prej symptomave të Palm lethal yellowing mycoplasma dhe Cadang-Cadang viroid nuk janë vërejtur mbi bimë që prej fillimit të ciklit të fundit të plotë vegjetativ, dhe bimët në vendin e prodhimit që kanë shfaqur simptoma duke ngritur dyshimin e kontaminimit nga organizmat e mësipërm janë asgjësuar në atë vend dhe bimët I janë nënshtruar trajtimit përkatës për pastimin e tyre nga *Myndus crudus* Van Duzee;

- (c) në rastin e bimëve *in vitro*, bimët kanë rrjedhur nga bimë që kanë plotësuar kërkesat e përshkruara në (a) ose (b)

38.1. Bimët e *Camellia* L. të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vende jo-Europiane

Deklarimi zyrtar që:

- (a) bimët janë me origjinë nga zona të njohura të jenë të pastra nga *Ciborinia camelliae* Kohn;

ose

- (b) asnjë symptomë e *Ciborinia camelliae* Kohn nuk është vërejtur mbi bimët në lulëzim që prej fillimit të ciklit të fundit, të plotë vegjetativ.

38.2. Bimët e *Fuchsia* L. të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga SH.B.A. ose Brazili

Deklarimi zyrtar që asnjë simptome e *Aculops fusciae* Keifer nuk është vërejtur në vendin e prodhimit dhe që menjëherë para eksportimit bimët janë inspektuar dhe janë gjetur të pastra nga *Aculops fusciae* Keifer.

39. Pemët dhe shkurret, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat dhe bimët *in vitro*, me origjinë nga vendet e treta (jo-anëtare të BE), të ndryshme nga vendet Europiane dhe Mesdhetare

Pa cënuar kushtet e aplikueshme për bimët të listuara përkatësisht në Aneksin III(a)(1), (2), (3), (9), (13), (15), (16), (17), (18), Aneksin III(B)(1) dhe Aneksin IV(A)(I)(8.1), (8.2), (9), (10), (11.1), (11.2), (12), (13.1), (13.2), (14), (15), (17), (18), (19.1), (19.2), (20), (22.1), (22.2), (23.1), (23.2), (24), (25.5), (25.6), (26), (27.1), (27.2), (28), (29), (32.1), (32.2), (33), (34), (36.1), (36.2),

(37), (38.1) dhe (38.2), deklarimi zyrtar që bimët:

janë të apstra (d.m.th. të pastra nga copra mbeturina bimore) dhe të pastra nga lulet dhe frutat,

janë rritur në fidanishte,

janë inspektuar në kohë të caktuara dhe para eksportimit dhe janë gjetur të pastra nga simptoma të parazitëve bacterialë, viruseve dhe organizmave si-viruset dhe gjithashtu janë gjetur të pastra nga shenja ose simptoma të nematodave, insekteve, këpushave, dhe kërpudhave parazitare, ose kanë qenë subject I trajtimeve përkatëse për eliminimin e organizmave të tillë.

40. Pemët dhe shkurret gjetherënëse, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat dhe bimët *in vitro*, me origjinë nga vendet e treta (jo-anëtare të BE), të ndryshme nga vendet Europiane dhe Mesdhetare

Pa cënuar kushtet e aplikueshme për bimët të listuara përkatësisht në Aneksin III(A)(2), (3), (9), (15), (16), (17) dhe (18), Aneksin III(B)(1) dhe Aneksin IV(A)(I), (11.1), (11.2), (11.3), (12), (13.1), (13.2), (14), (15), (17), (18), (19.1), (19.2), (20), (22.1), (22.2), (23.1), (23.2), (24), (33), (36.1), (38.1), (38.2), (39) dhe (45.1) deklarimi zyrtar që bimët janë të fjetura (në gjendje qetësie) dhe janë pa gjethe.

41. Bimët një dhe dy vjecare, të ndryshme nga Gramineae, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vende ndryshe nga ato Europiane dhe Mesdhetare

Pa cënuar kushtet e aplikueshme për bimët, përkatësisht të listuara në Aneksin III(A)(11), (13), dhe Aneksin IV(A)(I)(25.5), (25.6), (32.1), (32.2), (32.3), (33), (34), (35.1) dhe (35.2), deklarimi zyrtar që bimët:

janë rritur në fidanishte,

janë pa copra mbeturina bimore, lule dhe fruta,

janë inspektuar në kohë të caktuara dhe para eksportimit, dhe

janë gjetur të pastra nga simptoma të parazitëve bacterialë, viruseve dhe organizmave si-viruset dhe

gjithashtu janë gjetur të pastra nga shenja ose simptoma të nematodave, insekteve, këpushave, dhe kërpudhave parazitare, ose kanë qenë subject I trajtimeve përkatëse për eliminimin e organizmave të tillë.

42. Bimët e familjes Gramineae barëra shumvjeçarë zbukurues të nën familjeve Bambusoideae, Panicoideae dhe të gjinive *Buchloe*, *Bouteloua* Lag., *Calamagrostis*, *Cortaderia* Stapf., *Glyceria* R. Br., *Hakonechloa* Mak. ex Honda, *Hystrix*, *Molinia*, *Phalaris* L., *Shibataea*, *Spartina* Schreb., *Stipa* L. dhe *Uniola* L. të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vende ndryshe nga ato Europiane dhe Mesdhetare

Pa cënuar kërkesat e aplikueshme për bimët, përkatësisht të listuara në Aneksin IV(A)(I)(33) dhe (34), deklarimi zyrtar që bimët:

janë rritur në fidanishte,

dhe

janë të pastra nga copra mbeturina bimore, lule dhe fruta,

dhe

janë inspektuar në kohë të caktuara dhe para eksportimit, dhe

janë gjetur të pastra nga simptoma të parazitëve bacterialë, viruseve dhe organizmave si-viruset dhe

gjithashtu janë gjetur të pastra nga shenja ose simptoma të nematodave, insekteve, këpushave, dhe kërpudhave parazitare, ose kanë qenë subject I trajtimeve përkatëse për eliminimin e organizmave të tillë.

43. Bimë të xhuxhëzuara në mënyrë natyrale ose

Pa cënuar kushtet e aplikueshme për bimët të listuara

artificiale të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vende jo-Europiane

përkatësisht në Aneksin III(A)(1), (2), (3), (9), (13), (15), (16), (17), (18), Aneksin III(B)(1), dhe Aneksin IV(A)(I)(8.1), (9), (10), (11.1), (11.2), (12), (13.1), (13.2), (14), (15), (17), (18), (19.1), (19.2), (20), (22.1), (22.2), (23.1), (23.2), (24), (25.5), (25.6), (26), (27.1), (27.2), (28), (32.1), (32.2), (33), (34), (36.1), (36.2), (37), (38.1), (38.2), (39), (40) dhe (42), deklarimi zyrtar që:

(a) bimët, përfshirë ato të mbledhura direkt nga vendjetesa natyrale, duhet të kenë qenë rritur, mbajtur dhe kalitur për të paktën dy vite të një pasnjëshëm përpara shpërndarjes në fidanishte të regjistruara zyrtarisht, të cilat janë subject I një regjimi kontrolli mbikqyrës zyrtar,

(b) bimët në fidanishte të referuara në (a) duhet të:

(aa) të paktën gjatë periudhës së referuar në (a):

të jenë vendosur në vazo, të cilat janë vendosur në tezga të ngritura së paku 50 cm. mbi tokë,

kanë qenë subject I trajtimeve përkatëse për të garantuar pastërtinë nga rncat jo-Europiane të ndryshqeve: lënda vepruese, përqëndrimi dhe data e trajtimeve duhet të jetë përmendur në certifikatën fitosanitare sipas Artikullit 7 të kësaj Direktive në rubrikën “dezinfestim dhe/ose dezinfestim”.

janë inspektuar zyrtarisht të paktën gjashtë herë në vit në intervale kohe të caktuara, për praninë e parazitëve që lidhen me to, që përmenden në Aneksin e kësaj Direktive. Këto inspektime, që gjithashtu duhet të jenë kryer mbi bimët në afërsi imediate me fidanishtet e referuara në (a), duhet të jenë kryer të paktën me anë të egzaminimit vizual në cdo rrjesht në fushë ose fidanishte dhe me anë të egzaminimit vizual mbi të gjitha pjesët e bimëve mbi terrenin rritës, duke përdorur një kampion të rastit prej së paku 300 bimë për gjini, ku numuri I bimëve për atë gjini nuk është më tepër se 3000, ose 10% të bimëve nëse janë mbi 3000 bimë prej asaj gjinie,

në këto inspektime janë gjetur të pastra nga parazitët përkatës të specifikuar në kryerradhën e mësipërme. Bimët e infektuara duhet të jenë larguar. Bimët e mbetura përkatësisht duhet të jenë trajtuar efektivisht, dhe përvec kësaj duhet të jenë mbajtur për një periudhë kohe të caktuar dhe të jenë inspektuar për të siguruar pastërtinë prej parazitëve që lidhen me ato,

janë mbjellë në terrene rritës artificialë të pa përdorur, ose në një terren rritës natyral që ka qenë trajtuar me fumigim ose me trajtim të përshtatshëm me nxehtësi dhe ka qenë pa parazitë,

ka qenë mbajtur në kondita të cilat sigurojnë që terreni rritës është mbajtur I pastër nga

parazitët dhe brenda dy javëve përpara shpërndarjes kanë qenë:

shkundur dhe larë me ujë të pastër për të larguar terrenin rritës original dhe për të nxjerrë në dukje rrënjëzimin, ose

shkundur dhe larë me ujë të pastër për të larguar terrenin rritës original dhe rimbjellë në terren rritës tjetër që plotëson kushtet e përshkruara në (aa) kryerradha e pestë, ose

kanë qenë subject I trajtimeve përkatëse për të siguruar që terreni rritës është I pastër nga parazitët, lënda vepruese, përqëndrimi dhe data e kryerjes së këtyre trajtimeve duhet të jetë përmendur në certifikatën fitosanitare sipas Artikullit 7 të kësaj Direktive në rubricën “dezinfestim dhe /ose dezinfektim”.

(bb) të jenë paketuar në konteinerë të mbyllur të cilët janë vulosur zyrtarisht ku del në pah numuri I regjistrimit të fidanishtes së regjistruar, ky numur gjithashtu duhet të tregohet në rubrikën *deklarime shtesë* të certifikatës fitosanitare sipas Artikullit 7 të kësaj Direktive, duke mundësuar identifikimin e ngarkesës.

44. Bimët barishtore shumëvjeçare të familjeve *Caryophyllaceae* (përvec *Dianthus* L.), *Compositae* (përvec *Dendranthema* (DC.) Des Moul.), *Cruciferae*, *Leguminosae* dhe *Rosaceae* (përvec *Fragaria* L.), të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vendet e treta (jo-anëtare të BE) , të ndryshme nga vendet Europiane dhe Mesdhetare

Pa cënuar kërkesat e aplikueshme për bimët e listuara përkatësisht në Aneksin IV(A)(I)(32.1), (32.2), (32.3), (33) dhe (34), deklarimi zyrtar që bimët:

janë rritur në fidanishte, dhe

janë të pastra nga copra mbeturinash bimore, lule dhe fruta, dhe

janë inspektuar në kohë të caktuara dhe para eksportimit, dhe

janë gjetur të pastra nga simptoma të parazitëve bakterialë, viruseve dhe organizmave si-viruset dhe

gjithashtu janë gjetur të pastra nga shenja ose simptoma të nematodave, insekteve, këpushave, dhe kërpudhave parazitare, ose kanë qenë subject i trajtimeve përkatëse për eliminimin e organizmave të tillë.

45.1. Specie të bimëve barishtore dhe bimët e *Ficus* L. dhe *Hibiscus* L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga bulbat, drithi, rizomat, farat dhe tuberët, me origjinë nga vende jo-Europiane

Pa cënuar kërkesat e aplikueshme për bimët në Aneksin IV, Pjesa A, Seksioni I(27.1), (27.2), (28), (29), (32.1), (32.3) dhe (36.1), deklarimi zyrtar që bimët:

(a) janë me origjinë nga një zonë, e përcaktuar nga shërbimi nacional I mbrojtjes së bimëve në vendin eksportues, që është e pastër nga *Bemisia tabaci* Genn. (populacione jo-Europiane) në pajtim me Standardet Ndërkombëtare përkatëse për Masat Fitosanitare, dhe kjo është përmendur në certifikatat e referuara në Artikujt 7 ose 8 të kësaj Direktive, në rubrikën “Deklarime shtesë”,

ose

(b) janë me origjinë nga një vend prodhimi, i përcaktuar nga shërbimi nacional I mbrojtjes së bimëve në vendin eksportues, që është i pastër nga *Bemisia tabaci* Genn. (populacione jo-Europiane) në pajtim me Standardet Ndërkombëtare përkatëse për Masat Fitosanitare, dhe kjo është përmendur në certifikatat e referuara në Artikujt 7 ose 8 të kësaj Direktive, në rubricën “Deklarime shtesë”, dhe janë deklaruar të pastra nga *Bemisia tabaci* Genn. (populacionet jo-Europiane) nga inspektimet zyrtare të kryera së paku një herë në cdo tre javë gjatë nëntë javëve të fundit para eksportimit,

ose

(c) në rastet ku *Bemisia tabaci* Genn. (populacionet jo-Europiane) janë gjetur në vendin e prodhimit, janë mbajtur ose prodhuar në këtë vend prodhimi dhe I janë nënshtruar një trajtimi përkatës për të siguruar pastërtinë nga *Bemisia tabaci* Genn. (populacione jo-Europiane) dhe më vonë ky vend prodhimi është gjetur I pastër nga *Bemisia tabaci* Genn. (populacionet jo-Europiane) si pasojë e implementimit të procedurave përkatëse duke synuar c’rrenjosjen e *Bemisia tabaci* Genn. (populacioneve jo-Europiane), në inspektimet zyrtare të kryera cdo javë gjatë nëntë javëve të fundit para eksportimit ashtu dhe në procedurat e monitorimit gjatë periudhës së përmendur më sipër. Detaje mbi trajtimet duhet të përmendur në certifikatat e referuara në Artikullin 7 ose 8 të kësaj Direktive.

45.2. lulet e prera të *Aster* spp., *Eryngium* L., *Gypsophila* L., *Hypericum* L., *Lisianthus* L., *Rosa* L., *Solidago* L., *Trachelium* L., dhe perimet gjethore të *Ocimum* L., me origjinë nga vende jo-Europiane

Deklarimi zyrtar që lulet e prera dhe perimet gjethore:

